artpolis art and community center

RAPORTI VJETOR 2022

PËRMBAJTJA

LETËR NGA DREJTORESHA EKZEKUTIVE E ARTPOLIS - QENDRA PËR ART DHE KOMUNITET 1

RRETH ARTPOLIS - QENDRA PËR ART DHE KOMUNITET 2

FEMART 10 – NGA REVOLUCIONI NË EVOLUCION 4

SHFAQJET DHE PERFORMANCAT PROFESIONALE 6

ÇIMKA 7

TOKA E SHPIRTRAVE TË TRAZUAR 8

ORA E VDEKJES 9

TOP GIRLS 10

SOBER 11

ZGJIMI I PRANVERËS 12

TOTEM DHE TABU 13

GJUETARET E ARTEMIDËS 14

POEZI PËR FUQI – ÇDO DITË ËSHTË 8 MARS 15

FONDI PËR ART FEMINIST 16

EKSPOZITA “FEMPIRE” 17

PERFORMANCA “VET” 18

KOREODRAMA “GRUA MOS HESHT” 19

“EQUAL” 20

PERFORMANCA MUZIKORE “SONATË E KRISTALTË” 21

PERFORMANCA POETIKE “WIG – POEZI QUEER” 22

PUNËTORIA “TERAPI ARTI” 23

PERFORMANCA KORALE “TI JE ARSYEJA E DIKUJT PËR TË BUZËQESHUR” 24

EKSPOZITA DHE MBRËMJA POETIKE “GRATEFUL” 25

MBRËMJA POETIKE “PAR FUMÉ” 26

SHFAQJA “RRËFIMET E GRAVE” 27

AKTIVIZMI FEMINIST 28

MARSHOJMË S’FESTOJMË 29

#BOLL MA! ABUZIMI NUK FSHEHËT BRENDA MUREVE 30

16 DITËT E AKTIVIZMIT KUNDËR DHUNËS ME BAZË GJINORE 31

ME VIDEO FEMINISTE PËR EMANCIPIM SHOQËROR 32

KONFERENCA DHE PUBLIKIMI I RAPORTIT “GJINIA DHE MARRËDHËNIET E PUSHTETIT” 33

KONFERENCA “REPREZENTIMI I BARABARTË NË TEATËR” 34

KURSI I VETËMBROJTJES “ÇIKAT E SJELLSHME” 35

DOKUMENTARI BIBA MAY – “JO MË” 37

DHJETË TRAJNIME “EDUKIMI I GRAVE TË REJA MBI FEMINIZMIN” 38

ADRESIMI I NGACMIMEVE SEKSUALE 39

ARTPOLIS ASISTON UNIVERSITETIN E PRISHTINËS NË ZBATIMIN E RREGULLORES 40

PËRDITËSIMI DHE SHPËRNDARJA E BROSHURËS “NGACMIMET SEKSUALE NË KOSOVË” 41

PËR HERË TË PARË MBAHEN NË UP 14 SESIONE INFORMUESE PËR ADRESIMIN E NGACMIMEVE SEKSUALE 42

AKTI GUERIL “MOS HESHT” 43

GRATË PËR PAQE 44

ARTPOLIS PËRMBYLL FORUMIN E GRAVE, PAQES DHE SIGURISË TË ORGANIZUAR NGA PRESIDENTJA OSMANI 45

SHKOLLA PRANVERORE FEMINISTE 46

AKTIVIZMI I PERSONIFIKUAR DHE GUXIMI PËR TË PUSHUAR 47

AKTIVIZMI I PERSONALIZUAR PËR REFLEKTIM DHE PROSPERITET NË MES TË GRAVE TË BALLKANIT 48

MEDIA DHE ARTI NË SHËRBIM TË PAJTIMIT 49

REBELIMI NDAJ SHTYPJES DHE PABARAZISË 50

VRASJA E GRAVE NGA BURRAT TË TRAJTOHET SI URGJENCË KOMBËTARE 51

MBROJTJE PËR VAJZAT DHE GRATË 52

HOMOFOB S’KI VEND NË KUVEND! 52

PO TË GJITHA GRATË 53

AKTORJA E ARTPOLIS DENONCON DHUNËN NDAJ NJË GRUAJE NË SHTËPINË E PLEQVE 53

FUQIZIMI I TË RINJVE DHE TË REJAVE **54**
PËRGATITJA E ARTISTËVE/EVE PËR AUDICIONE 55
ARTISTËT E RINJ PËRGATITEN PËR KRIJIM TË CV-SË DHE PORTFOLIOS 56
PUNËTORIA “TEKNOLOGJIA DHE ARTI” 57
TRAJNIMI “EDUKIMI I BAZUAR NË TEATËR” 58
TRAJNIMI I PROGRAMIT TË FORUM TEATRIT I BASHKOI TË RINJTË/REJAT E KOMUNITETEVE 59
TRAJNIMI I PROGRAMIT TË FORUM TEATRIT BASHKON KOMUNITETIN SHQIPTAR DHE SERB 60
FËMIJË DHE TË RINJ/REJA MËSOJNË PËR BARAZINË GJINORE ME ARTISTEN SELMA SELMAN 61

THEMELOHEN PESË KLUBE TEATRORE, PREZANTOHEN NËNTË SHFAQJE FORUM TEATËR **62**
SHFAQJA “EDHE SA ROMEO TË TJERË”, KUNDËR NGACMIMEVE SEKSUALE NË SHKOLLA 63
SHFAQJA “JETA MË PËRKET MUA” NDËRTHUR SHANTAZHIN DHE BULLIZMIN KIBERNETIK 64
SHFAQJA “UNË JAM PASURI” RRËFIM DASHURIE QË SFIDON RACIZMIN 65
SHFAQJA “LE T’NDRYSHOJMË!”, SI THIRRJE KUNDËR RACIZMIT 66
TË RINJTË NGA VUSHTRRIA SHFAQIN TALENTIN SHUMËDIMENSIONAL 67
SHFAQJA “EKLIPS” ME MESAZH KUNDËR DHUNËS NDAJ GRAVE 68
SHFAQJA FORUM TEATËR “...EDHE MUA” ME DY PREZANTIME 69
SHFAQJA “VALLËZO PA FRIKË”, ME MESAZHE KUNDËR NGACMIMEVE SEKSUALE 70
SHFAQJA “ANOTHER BRICK IN THE WALL”, MBI ANKTHIN E NXËNËSVE NË SHKOLLË 71

NGRITJA E KAPACITETEVE TË STAFIT TË ARTPOLIS **72**
PLANIFIKIMI STRATEGJIK DHE MEL 73
NGRITJA E KAPACITETEVE TË ARTISTËVE/EVE DHE AKTIVISTËVE/EVE TË ARTPOLIS 74
STAFI DHE TRUPA E ARTPOLIS DISKUTOJNË MBI STRATEGJINË 2023-2027 75

VIZITAT DHE BASHKËPUNIMET E REJA **76**
BUÇAJ SPONSOR GJENERAL I ARTPOLIS 77
BASHKËPUNIMI FRANCEZ 78
ZANA HOXHA LAUREATE E ÇMIMIT “LIDERET E SË ARDHMES” NGA FRANCA 79
ZANA HOXHA VIZITOI “ISRA-DRAMA: EKSPOZIMIN NDËRKOMBËTAR TË TEATRIT IZRAELIT” 80
ARTPOLIS NË PARTNERITET ME PRIZRENFEST 81
SHKËMBIMET KULTURORE ME ARTISTË/E 82
STUDENTË/E NGA VJENA DHE VENECIA NJOFTOHEN ME PUNËN E ARTPOLIS 83

ARTPOLIS ME KOMUNITET TË ZGJERUAR **84**
BLLOGJET **85**
VLERËSIMI DHE MONITORIMI **86**
SFIDAT DHE MËSIMET E NXJERRA **86**
ÇFARË THONË TË TJERËT PËR ARTPOLIS **87**
ANEKSET **89**
STATISTIKAT E MEDIAVE SOCIALE **90**
DONATORËT E ARTPOLIS **91**
RRJETET SOCIALE TË ARTPOLIS DHE FESTIVALIT FEMART **92**
MONITORIMI I MEDIAVE **93**
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE **94**
TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET NGA DONATORËT **95**
STAFI I QENDRËS PËR ART DHE KOMUNITET - ARTPOLIS, 2022 **96**
TRUPA ARTISTIKE REZIDENTE E ARTPOLIS **97**
BORDI I ARTPOLIS **98**

Artpolis – Qendra për Art dhe Komunitet
Adresa: Rr. Mujo Ulqinaku 8/8 (Qyteza Pejton)
10 000 Prishtina, Kosova
Tel: + 383 38 221 512

E-mail: ojq.artpolis@gmail.com

Facebook: https://www.facebook.com/artpolisKosovo/
Instagram: https://www.instagram.com/artpoliscenter/
Vimeo: https://vimeo.com/artpoliscenter

Letër nga Drejtoresha Ekzekutive e Artpolis - Qendra për Art dhe Komunitet

Zana Hoxha

Viti 2022 shënoi një nga rritjet më të mëdha të krijimeve artistike të Artpolis, krahas aktivizmit feminist të mbushur me sfida, mësime, emancipim dhe kujtime të bukura.

Sivjet shënuam 10 vjet FemArt. 10 vjet angazhim artistik dhe aktivizëm feminist. 10 vjet art i angazhuar i artisteve dhe aktivisteve vendore dhe ndërkombëtare. 10 vjet përpjekje e përbashkët për barazi gjinore, emancipim shoqëror dhe sfidim të mentalitetit patriarkal. 10 vjet revolucion feminist për evolucion shoqëror.

Këtë vit i shtuam skenës teatrore edhe pesë shfaqje profesionale, tri prej tyre në bashkëproduksion me Teatrin Eksperimental “Kujtim Spahivogli”, Teatrin Dodona, si dhe Kompaninë Teatrore “Bokshi”. Rezultatet e arritura me Trupën Artistike Rezidente të Artpolis na motivojnë që të zgjerojmë bashkëpunimet, dhe të rrisim angazhimin për transformim pozitiv shoqëror.

Artpolis hapi edhe një dritare për artistet/ët dhe aktivistet/ët e reja/rinj duke themeluar Fondin për Art Feminist. Një nismë për të rritur angazhimin artistik, kapacitetin krijues, dhe punën e artisteve/ëve në komunitet.

Kemi ngritur zërin edhe këtë herë për grupet e margjinalizuara, veçanërisht për komunitetin e personave me aftësi të kufizuara. Jemi më të forta kur jemi së bashku kundër pabarazisë, diskriminimit dhe patriarkalizmit.

U jam mirënjohëse artisteve/ëve, aktivisteve/ëve, Trupës dhe stafit të Artpolis për guximin, vullnetin dhe kreativitetin për të sjellë ndryshimin në shoqëri. Ky ndryshim u arrit edhe falë mbështetjes së partnerëve tanë – donatorëve, të cilët i falënderojmë për besimin në aktivizmin tonë artistik.

RRETH ARTPOLIS - QENDRA PËR ART DHE KOMUNITET

Artpolis është organizatë joqeveritare që përmes kulturës, artit, edukimit dhe dialogut social ndikon në komunikimin dhe transformimin pozitiv të bashkëjetesës në komunitet.

E themeluar më 2004, vizioni i Artpolis është të krijojë një shoqëri të bazuar në vlera feministe në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Misioni i Artpolis është të ndërtojë fuqinë kulturore të grave dhe të rinjve për t'u bërë inspirimi dhe ndikimi i shoqërisë për ndryshim. Vlerat e Artpolis janë: feminizmi, barazia gjinore, drejtësia, paqja, edukimi, fuqizimi, emancipimi, humanizmi dhe besnikëria.

Artpolis identifikohet lehtë si një ndër organizatat unike, e cila e përdorë teatrin dhe format e tjera artistike për të afirmuar, avokuar, edukuar dhe promovuar të drejtat e grave, të drejtat e njeriut, të drejtat e grupeve të margjinalizuara, barazinë gjinore, komunikimin me komunitetet multietnike, ndërtimin e paqes, fuqizimin e grave dhe të rinjve e të rejave. Ky aktivizëm artistik e bën të veçantë organizatën Artpolis, më afër qytetarëve, dhe ndërton relacione të sinqerta e më të fuqishme në komunikimin e përbashkët me komunitetin, duke gjetur përkrahjen e tyre. Ajo çka e dallon Artpolis-in nga organizatat e tjera joqeveritare është bashkëpunimi kreativ dhe edukativ me të rinjtë/rejat në nivel të lartë, përkrahja e komuniteteve pakicë, gjithëpërfshirja, diversiteti i grave në pushtet, ngritja e zërit kundër dhunës, pjesëmarrja aktive dhe masive e përkrahur nga komuniteti.

Disa nga aktivitetet kryesore të Artpolis janë: shfaqje profesionale teatrore, lexime skenike, trajnime, punëtori, konferenca, publikime, panele diskutimesh, ligjërata dhe diskutime publike, shfaqje filmash, koncerte, vallëzime bashkëkohore, protesta, marshe, fushata, performanca, pjesëmarrje në festivale teatrore jashtë vendit, aktivitete në rrugë me të rinj/reja, ekspozita, murale dhe instalacione, mbrëmje poezish, mbrëmje letrare dhe promovim librash, shfaqje forum teatër, mbrëmje përkujtimore të artisteve/ëve, joga dhe meditime, podkaste, intervista mediale, bashkëpunim me mediat dhe grupet artistike ndërkombëtare, ndërtimi i relacionit me aktivistë ndërkombëtarë, edukim feminist, edukim teatror, ngritje të kapaciteteve, buletini dy javor, rrjetet sociale, vullnetarizmi dhe takime me artistë.

Aplikimi i punës së Artpolis shtrihet në katër shtylla:

Shtylla (I) -Të krijojë një shoqëri të bazuar në vlera feministe në rajonin e Ballkanit Perëndimor, duke i promovuar të drejtat e njeriut, barazinë gjinore, sfidimin e mendësisë patriarkale në Kosovë përmes kulturës dhe artit.

Shtylla (II) - Të ndërtojë fuqinë kulturore të grave dhe të rinjve për t'u bërë inspirimi dhe ndikimi i shoqërisë për ndryshim duke e fuqizuar mirëqenien e grave dhe vajzave, ndikuar në barazinë gjinore **përmes aktiviteteve të fokusuara në grupet e synuara.**

Shtylla (III) - Edukimi i të rinjve/rejave përmes aktiviteteve artistike në kuadër të punës së Qendrës së Artit dhe Kulturës duke i përdorur vlerat e Artpolis: feminizmi, barazia gjinore, drejtësia, paqja, edukimi, fuqizimi, emancipimi, humanizmi dhe besnikëria.

Shtylla IV - Investimi në qëndrueshmërinë financiare dhe institucionale të Artpolis duke ngritur kapacitetet dhe ndërtuar sukseset me komunitetet përkatëse.

Aktivitetet e Artpolis janë të shtrira pothuajse në të gjitha komunat e Kosovës dhe në rajon, duke adresuar, trajtuar, ndikuar e ndërruar kufizimet e mendësisë patriarkale, duke ofruar vepra artistike e teatrore me artistë eminent të Kosovës dhe të rajonit, **për qytetarët e në veçanti për të rinjtë e Kosovës; për të ngritur vetëdijen dhe angazhimin e tyre.**

Artpolis - Qendra për Art dhe Komunitet ka një lidhje të ngushtë me mediat zyrtare të Kosovës, artistët e teatrit dhe filmit; është pjesëtare e ISPA-së (International Performing Arts Association; www.ispa.org), Rrjetit IETM, Rrjetit të Grave të Kosovës, Forumit Kulturor, CIVIKOS, Koalicionit për Shëndetin Riprodhues, Koalicioni i Kosovës për Pajtim dhe punon me artistë dhe aktivistë me prejardhje të ndryshme etnike.

RRETH RAPORTIT VJETOR 2022 TË ARTPOLIS

Ky vit u karakterizua me rritjen artistike të Artpolis; krijimin e pesë shfaqjeve profesionale teatrore, tri prej tyre në bashkëproduksion. Gjithëpërfshirja, diversiteti dhe puna në komunitet janë zgjeruar, posaçërisht hapësira dedikuar personave me aftësi të veçanta, të cilat/ët ishin pjesë e trajnimeve, marsheve, punëtorive, dhe fushatave për barazi gjinore dhe emancipim shoqëror.

Çdo vit, Artpolis raporton tek Bordi, partnerët dhe miqtë lidhur me përparimin që është bërë drejt arritjes së objektivave strategjike. Ky Raport bazohet në katër shtyllat kryesore të organizatës, përmes së cilave është realizuar vizioni, misioni dhe vlerat afatgjate të organizatës. Në këtë Raport prezantohet progresi i punës, të arriturat dhe rezultatet e programit për vitin 2022. Në vazhdimësi janë të detajuara të gjitha aktivitetet të ndara sipas shtyllave.

FEMART 10 – NGA REVOLUCIONI NË EVOLUCION

Foto: Rilind Beqa

Evolucioni feminist vazhdoi. Sivjet edhe më i gjerë e më i plotë. Artiste, aktiviste e feministe vendore dhe ndërkombëtare u pikëtakuan sërish në Festivalin e parë feminist në Kosovë e më të madhin në rajon, FemArt.

FemArt 10, për dhjetë ditë me radhë, 14-23 qershor 2022, shpërfaqi aftësinë e grave artiste për t'u përmbushur, inspiruar e për të gjetur paqen. U mblodhëm nën moton "Nga Revolucioni në Evolucion" për të festuar një dekadë të njohjes e nderimit të guximit të grave artiste, fuqisë kreative, e angazhimit të tyre për barazi e drejtësi përmes shfaqjeve teatrore, baletit flamengo, vallëzimit bashkëkohor, koncerteve, konferencave, diskutimeve, trajnimeve dhe punëtorive nga Kosova, Shqipëria, Serbia, Gjermania, Portugalia, Spanja, Izraeli, Ishujt Reunion, Italia dhe Franca.

Një dekadë guxim, krenari e dashuri. Për një dekadë kemi krijuar ngjarje, thyer barriera e ndërtuar ura të reja të paqes në vend, rajon e më gjerë. Jemi rebeluar për të këputur fijet e patriarkatit, e shkundur mendësinë e dëmshme të së vjetrës.

Aktivizmi ynë artistik-feminist erdhi si një përgjigje për t'u shëruar e kuptuar, për të krijuar e transformuar shoqërinë e jetën. Mbi të gjitha për të shkër-

Foto: Rilind Beqa

muar secilin nocion të normuar mbi pabarazinë. Ky angazhim ka frymuar falë dashurisë për artin, aktivizmin, jetën, ekzistencën, barazinë e drejtësinë.

Në këtë dhjetë vjetor, për dhjetë ditë festuam e u rebeluam, argëtuam e inspiruam, performuam e bëmë thirrje për barazi, drejtësi, fuqizim e njohje të kontributit të grave, artisteve e aktivisteve deri në revolucionin e radhës.

REZULTATET KRYESORE TË FEMART 10:

- Tridhjetë e katër aktivitete (34) të organizuara
- Njëqind e pesëdhjetë (150) artistë/e dhe aktivistë/e pjesëmarrës/e
- Dhjetë (10) vullnetarë/e të angazhuar
- 2520 persona ndoqën fizikisht aktivitetet e FemArt 10
- Kemi arritur 348,432 persona përmes rrjeteve sociale
- Diskutime dhe intervista mediatike
- 52 artikuj medial
- 11 bllogje të publikuara

SHFAQJET DHE PERFORMANCAT PROFESIONALE

Trupa Artistike Rezidente e Artpolis ka pasur një ngritje të jashtëzakonshme profesionale më 2022. Në portfolion e saj janë shtuar edhe katër shfaqje teatrore: “Çimka”, “Toka e Shpirtrave të Trazuar”, “Top Girls”, dhe “Sober”. Derisa Artpolis në bashkëproduksion me Kompaninë Teatrore “Bokshi” ka sjellë premierën speciale në FemArt 10 shfaqjen “Ora e Vdekjes”.

Ndërsa ka zgjeruar bashkëproduksionet edhe me Teatrin Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli” nga Shqipëria (Çimka), dhe TQP Dodona (Top Girls).

Më 2022 ka vazhduar rrugëtimi vendor dhe ndërkombëtar i “Zgjimit të Pranverës”, “Totem dhe Tabu”, dhe “Gjuetaret e Artemidës”. Në katër prezantime në Prishtinë, Prizren, Sllloveni dhe Maqedoni Veriore shfaqja “Zgjimi i Pranverës” u prezantua para një audience prej 600 personash. Kurse “Totem dhe Tabu” ishte pjesë e Festivalit “Balkan Breeze” në Bursa të Turqisë më 19 dhe 20 mars, duke u prezantuar para 170 personave në audiencë. “Gjuetaret e Artemidës” këtë herë u prezantua në Beograd në kuadër të Festivalit “Arts & Human Rights” organizuar nga Dah Teatri.

Për këto **8 shfaqje** të prezantuara **40 premiera/repriza** para **3488 personave në audiencë** në Kosovë, Shqipëri, Sllloveni, Serbi, Turqi, dhe Maqedoni Veriore u angazhuan **70 artiste/ë dhe aktore/ë**, si dhe **21 persona si staf teknik**.

ÇIMKA

Foto: Andis Rado

Në mbrëmjen e 1 majit, 2022 publiku pati rastin të përjetojë emocione të veçanta në premierën e shfaqjes “ÇIMKA”, me autor Shpëtim Selmani dhe regji të Zana Hoxhës.

E jetësuar në “Shtëpinë me Gjethe” në Tiranë, aty kur dikur përgjoheshin personalitete e qytetarë të thjeshtë, “ÇIMKA” erdhi si pasqyrim i të kaluarës së popullit shqiptar, e thirrje për të reflektuar e mësuar nga ajo.

Publiku si “gjeth” apo “çimkë” përjetoi njëherësh dy botë paralele, diktaturën në Shqipëri dhe regjimin jugosllav në Kosovë. Historitë e përgjimeve, torturat, tmerri, dhe shtypja e mijëra shqiptarëve u jetësua me mjeshtëri përmes dy protagonistëve, Dervish Shaqa dhe Musine Kokalari.

Për regjisoren Zana Hoxha, protagonistët e shfaqjes “ÇIMKA” janë simbole të rezistencës në mënyra të ndryshme: “Një rapsod, qëndrestar përmes këngës, e tjetra një aktiviste, artiste disidente që dha jetën pa humbur integritetin e saj”.

Por, ëndrrat, dashuria për lirinë dhe jetën, këngën dhe vallëzimin kulmojnë në takimin e Dervishit dhe Musinesë, viktima të regjimeve në të dy anët e kufirit. Personazhe që inspirojnë për jetën edhe sot e kësaj dite.

Shfaqja u përmbyll me një mesazh të fuqishëm nga Musine Kokalari: “E vërteta është se këtu mbizotëron frika, terrori. Po kush ka guxim të thotë jo, kush? Askush! Ama brenda zemrës sime sundojnë ëndrrat. E di që nëse jo unë, ata që do të vijnë pas meje do të vallëzojnë, do të hedhin hapat ashtu sikurse duan ata vet. Asnjë sistem sundues nuk do të mund ta hedhë dot rrjetën e tij mbi nevojën e njeriut për të ushtruar vullnetin e lirë”.

Përveç premierës “Çimka” pati edhe nëntë prezantime të tjera më 4, 5, 6, 7, 11, 12, 13, 14 dhe 15 maj, duke mbledhur 535 persona në audiencë.

TOKA E SHPIRTRAVE TË TRAZUAR

Foto: Rilind Beqa

E mbushur me skena dramatike, muzikë, këndim, video projeksione dhe koreografi bashkëkohore shfaqja “Toka e Shpirtrave të Trazuar” hapi edicionin e dhjetë të Festivalit FemArt me premierë në Teatrin Kombëtar të Kosovës, më 14 qershor, 2022.

Me regji të Zana Hoxhës poezitë e Shqipe Malushit u transformuan në imazhe lëvizëse. “Toka e Shpirtrave të Trazuar”, ishte një katarsis për publikun edhe me prezantimet në edicionin e parë të Forumit të Grave, Paqes dhe Sigurisë, organizuar nga Zyra e Presidencës, më 23 tetor, 2022. Kurse pati edhe dy prezantime në Pejë dhe Gjakovë më 29 dhe 30 nëntor në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizmit.

Kjo shfaqje është një rikthim mjeshtëror i kujtimeve që të shkundin qenien, e të mbajnë nën ethe për më shumë se një orë.

Mbi 920 persona kanë shikuar “Tokën e Shpirtrave të Trazuar” në katër prezantime.

ORA E VDEKJES

Foto: Rilind Beqa

Artpolis në bashkëpunim me Kompaninë Teatrore “Bokshi” më 23 qershor, 2022 ka sjellë premierën e shfaqjes “Ora e Vdekjes”, me regji të Ilir Bokshit, në Burgun Muze të Prishtinës.

“Ora e vdekjes”, që trajtoi fatin e të burgosurve politikë në Kosovë dhe Shqipëri, ka pasur 12 repriza këtë vit, përfshirë prezantimin në PrizrenFest dhe Kosovo Theatre Showcase. Shfaqja përfshin tregime nga të mbijetuarit (nga masakra e burgut të Dubravës) si dhe tregime nga të burgosurit nëpër burgjet e tjera të luftës së fundit në Kosovë dhe kohës së komunizmit në Shqipëri.

Projekti trajtoi jetën, moralin, identitetin, fatet, luftën, mbijetesën dhe dashurinë, gabimin dhe pafajësinë, lirinë dhe vdekjen, të gjitha këto të gërshetuara në një koncept inovativ teatror.

TOP GIRLS

Foto: Esad Duraki

Artpolis ka pasur bashkëpunim edhe me Teatrin e Qytetit të Prishtinës “Dodona”. Rezultat i këtij bashkëpunimi ishte shfaqja “Top Girls”, me regji të Shkurtë Aliut, që u dha premierë më 18 tetor, 2022.

“Top Girls” është një shfaqje e vitit 1982 e dramaturges britanike Caryl Churchill. Historitë e panumërta që Churchill paraqet në shfaqje tregojnë se çfarë presioni dhe se sa çrregulluese mund të jetë jeta e jetuar nën patriarkatin. Shfaqja tregon rolet e grave në shoqërinë moderne dhe betejat me të cilat ato përballen për të arritur sukseset në jetën e tyre profesionale, dhe për atë se çfarë do të thotë të jesh grua e suksesshme në shoqëri. Gratë nuk do të çlirohen kurrë me të vërtetë derisa të çlirohen nga kufijtë e shoqërisë patriarkale.

Në tri prezantime gjatë vitit 2022 “Top Girls” është ndjekur nga 313 persona në audiencë.

SOBER

Foto: Esad Duraki

Më 19 dhjetor, 2022 është dhënë premiera e shfaqjes “Sober”, me regji të Butrint Pashës, tek Dispanzeri, afër QKMF-së në Prishtinë.

“Sober”, e cila bazohet në veprën e Duncan Mac-Millan “Njerëz, vende dhe gjëra”, është një histori suksesi ku një njeri arrin të mposhtë varësinë ndaj drogës, fenomenit botëror që në vazhdimësi vret njerëz dhe shkatërron familje. E bazuar në një ngjarje sentimentale të një vajze që vuan nga alkoolizmi dhe varësia ndaj drogës që po rehabilitohet në një qendër, Ema vjen si personifikim i shumë njerëzve të stigmatizuar nga shoqëria për shkak të pasigurisë që i është krijuar nga varësia, që ka ndikuar edhe në karakterin e saj.

ZGJIMI I PRANVERËS

Më 4 korrik, 2022 Shfaqja muzikore “Zgjimi i Pranverës”, me regji të Zana Hoxhës, u prezantua para publikut në Sllloveni, me ç’rast u ndjek nga Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, si dhe ministrja e Kulturës së Sllovenisë, Asta Vrečko.

Pas prezantimit të suksesshëm në Sllloveni, “Zgjimi i Pranverës” u prezantua edhe në edicionin e parë të Festivalit të teatrit “PrizrenFest”, më 3 gusht.

Me regji të Zana Hoxhës kryevepra e autorit Frank Wedekind “Zgjimi i Pranverës” është adaptuar në Kosovën e viteve të ’90-ta. Nevoja e të rinjve për të kuptuar dhe për t’u kuptuar ka qenë dhe vazhdon të jetë sfidë, sidomos historia që i ka përcjellë të rinjtë tanë në vitet e ’90-ta, kohë protestash e rezistence, kohë kur liria kolektive dhe personale ishte e kufizuar nga regjimi politik i Millosheviqit dhe patriarkati, përderisa solidariteti mbante gjallë frymën e rezistencës kolektive.

TOTEM DHE TABU

“Totem dhe Tabu”, që është produksion i Artpolis, u prezantua para publikut në qytetin e Bursës në kuadër të Festivalit Ndërkombëtar të Teatrit të Vendeve të Ballkanit “Balkan Breeze”, si përfaqësues i shtetit të Kosovës.

Në dy paraqitjet e saj, më 19 dhe 20 mars, në edicionin e nëntë të këtij festivali, “Totem dhe Tabu” mblodhi mbi 170 persona në publik, duke sjellë energji, e duke reflektuar mbi situata dhe shqetësime të mëdha shoqërore, traumat, ndikimin e teknologjisë dhe Covid-19, hipokrizinë, por pa ardhur në konkludime, me synimin që të prekë në thellësinë e përjetimeve, emocioneve dhe ngjarjeve të cilat vijnë në formë imazhesh dhe gjuhë abstrakte të konkretizuar herë-herë me fjalë, si element tjetër i rëndësishëm.

Me koreografi nga Robert Nuha dhe dramaturgji të Zana Hoxhës shfaqja ka trajtuar temat që mbeten të izoluara brenda “kornizave” individuale dhe kolektive që janë tabu për shoqërinë apo nuk arrijnë të depërtojnë në diskursin publik.

Prezent në këto dy paraqitje të Trupës Artistike Rezidente të Artpolis ishin personalitete të rëndësishme të artit, kulturës, e diplomatë shqiptarë në Turqi.

GJUETARET E ARTEMIDËS

Foto: Djordje Tomić

Performanca skenike “Gjuetaret e Artemidës” me regji të Zana Hoxhës, mori rrugëtimin për në Beograd dhe me datë 25 shkurt u prezantua para publikut në Festivalin “Arts & Human Rights” që organizohet nga Dah Teatar.

Natyra është perëndeshë shëruese, burim i jetës dhe energjisë së pashtershme - të jetojmë në përputhje me ligjet e saj nënkupton të shërohemi fizikisht, emocionalisht dhe mentalisht. Frika, lumturia, trishtimi dhe zemërimi janë emocionet mbi të cilat ndërtohet jeta dhe çdo gjë që ngjallë frikë, trishtim apo zemërim, sulmon lumturinë dhe prishë qetësinë.

“Gjuetaret e Artemidës” personifikojnë shpirtin e një gruaje të pavarur duke bërë ritualet pagane dhe duke dhënë dashuri e solidaritet në harmoni me natyrën.

POEZI PËR FUQI – ÇDO DITË ËSHTË 8 MARS

Foto: Rilind Beqa

Në mbrëmjen e poezisë “Poezi për Fuqi – Çdo ditë është 8 Mars” artistët/et u njësuan për t’i dhënë zë grave të shtypura, e për t’i thënë stop dhunës së patriarkatit. Përmes poezisë e muzikës, aktrimit e vallëzimit këta artiste/ë prekën breza të tërë përmes rrëfimeve e performancës së tyre.

26 artiste/ë dhe 250 persona në publik ishin prezent në mbrëmjen e poezisë të mbajtur më 5 Mars në Teatrin Kombëtar të Kosovës. “Poezi për Fuqi” ishte dedikim edhe për popullin e Ukrainës dhe lirinë e tyre.

Edhe këtë herë “Poezi për Fuqi - Çdo ditë është 8 Mars”, solli solidaritet për gratë mbijetuese të dhunës në baza gjinore dhe të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë duke dedikuar paratë e biletave për këtë kategori më të ndjeshme!

FONDI PËR ART FEMINIST

11 vepra artistike me qasje feministe janë prezantuar sivjet në kuadër të Fondit për Art Feminist të Qendrës për Art dhe Komunitet – Artpolis, në të cilën janë përfshirë **87 artiste/ë dhe 10 staf teknik**. Një nismë për të përkrahur artin dhe aktivizmin feminist të të rinjve/rejave të fushave të ndryshme.

Shfaqje teatrore, ekspozita, mbrëmje të poezisë, performanca muzikore, terapi arti e forma të tjera artistike u prezantuan nga artiste/ë dhe grupe artistike përgjatë vitit 2022.

EKSPOZITA “FEMPIRE”

Ekspozita “Fempire” nga artistja Fjolla Ferati ishte aktiviteti i parë i prezantuar në kuadër të Fondit për Art feminist.

E hapur më 17 janar 2022 në Bibliotekën Kombëtare “Fempire” trajtoi temën e diversitetit. Gratë janë bashkuar në një punim të vetëm për të theksuar se përkundër ndryshimeve që mund të kenë mes vete, ato mund të bashkohen në solidaritet. Prandaj, ato ishin paraqitur në një vepër të përbashkët. Pesë gra që rrëfejnë 5 histori të ndryshme. Dashuria për veten dhe pranimi i të ndryshmes është esencial për një jetë të plotë. Shpresa qëndron tek përpjekja e secilës prej tyre!

Kjo ekspozitë qëndroi e hapur për dy javë në korridorin e Bibliotekës Kombëtare.

PERFORMANCA “VET”

Foto: Rilind Beqa

Emocione të fuqishme e të përziera për dhimbjen e krenarinë, dashurinë dhe ankthin, sfidat e paragjykimet u shpalosën para publikut përmes performancës “Vet’”, një vepër për dashurinë queer.

“Vet’”, nga Andi Krasniqi e Arbnora Ademi, erdhi si një reflektim mbi të drejtat e njeriut dhe të grave, përmes rrugëtimit jetësor të personazhit kryesor që arrin të thyejë mentalitetin patriarkal dhe paragjykimet me të cilat sfidohet. Në skenën e vogël të Teatrit Kombëtar më 14 shkurt 2022, triumfoi dashuria e madhe për vetveten, e për identitetin gjinor si një dashuri e veçantë dhe e rrallë.

Përmes një udhëtimi emocional publiku përjetoi ëndrrat, frikën, dyshimet e depresionin. I pa ato teksa shndërroheshin në copëza kujtimesh për t’i lënë vend të resë – triumfit të dashurisë për jetën.

KOREODRAMA “GRUA MOS HESHT”

Më 18 shkurt në Teatrin Oda është prezantuar koreodrama “Grua mos hesht” nga Leudrita Mustafa, që erdhi si thirrje për të gjitha gratë që të mos tolerojnë padrejtësitë e të kërkojnë ndihmë për t’u çliruar nga prangat e patriarkatit.

Përmes vallëzimit bashkëkohor dhe narracionit u portretizua një çift në faza të ndryshme të lidhjes së tyre dhe lufta e vajzës për t’u çliruar nga një lidhje toksike, për ta arritur lirinë.

“EQUAL”

Foto: Rilind Beqa

Më 22 shkurt, në skenën e Teatrit Kombëtar të Kosovës u prezantua premiera e shfaqjes së dansit bashkëkohor “Equal” me koncept dhe koreografi nga Robert Nuha.

Shfaqja “Equal”, që lindi si ide e ndikuar nga rastet e fundit të dhunës dhe vrasjeve në shoqëri, preku temën e barazisë gjinore që është një prej vlerave thelbësore të një shoqërie. Përmes imazheve të trupës së valltarëve të “Noa Dance Theater” u pasqyruan situata që ngritin pyetje mbi çështjet fragjile të barazisë gjinore.

Kërcimtarët tentuan të lidhin mendjen dhe trupin përmes lëvizjeve të tyre, duke i lejuar trupat e tyre të shprehin lirshëm ndjenjat më të thella dhe njëkohësisht të përçojnë mesazh duke nxjerrë në pah fuqinë dhe rëndësinë e gruas, rëndësinë dhe nevojën e barazisë, përgjegjësinë kolektive ndaj fenomeneve të dëmshme për shoqërinë tonë si dhe shtypjen gjinore si akt i dhunshëm dhe i dëmshëm fizik e psiqik.

PERFORMANCA MUZIKORE “SONATË E KRISTALTË”

“Sonatë e Kristaltë”, një performancë në siluetë, e luajtur në violë e piano, solli narracionin mbi sfidat dhe paragjykimet me të cilat përballen instrumentistët, veçanërisht gratë.

Të “fshehura” pas perdes, Entela Qarkagjija dhe Era Haliti performuan në Fakultetin e Muzikës më 24 shkurt. Ato thyen stereotipet gjinore. Përçuan mesazhin se nuk është aspak e rëndësishme se kush fshihet pas perdes, si po duket apo çfarë ka veshur, e rëndësishme është që arti duhet të vlerësohet si i tillë, për përmbajtjen dhe cilësinë.

PERFORMANCA POETIKE “WIG – POEZI QUEER”

Në mbrëmjen e 11 qershorit, 2022 në Prishtinë është prezantuar performanca poetike “Wig-Poezi Queer” nga artistja Arlinda Morina. Përmes “Wig-Poezi Queer”, ideja mori me vete një kuptim të guximit, të shtypjes së ndjenjave për dashurinë, stilin dhe mënyrën e shprehjes së mendimit, që gjykohet nga një pjesë e shoqërisë e cila s’mund të pranojë një mënyrë tjetër të jetesës.

Dashuria e gjinisë së njëjtë shkon përtej normave të patriarkatit, dhe përmes “Wig – Poezi Queer” rrëfimet e kësaj dashurie u jetësuan, shpalosën diversitetin poetik të ngjyrave të kostumeve të komunitetit LGBTQ+.

Në ballkonin e shtëpisë në Bregun e Diellit poezitë queer u prezantuan nga Valon Sejdiu a.ka. Agatha, Arlinda Morina, dhe Amar Havziji. Një natë poetike me drag-queen, me poezi shqip dhe anglisht, që njëherësh shërbeu për prezantimin e kostumeve në atë se si ndjehen artistët e kulturës Drag-queen. Në këtë mbrëmje u interpretuan poezi të Arbër Selmanit, Uresa Ahmetit dhe Audre Lorde.

Publiku u bë pjesë e rëndësishme e kësaj mbrëmje poetike, duke shpalosur tregimet, ngjarjet por edhe poezitë personale apo ato që i preferojnë. Anisa Ismaili, Agnes Nokshiq, Xhejlane Tërbunja, Zake Prelvukaj, Nora Murseli, Arta Muçaj, Albana Muja dhe Mimoza Shala interpretuan poezi të veçanta për dashurinë, jetën e lirinë. Përveç interpretimit të poezive në këtë mbrëmje Fiona Abdullahu dhe Drin Berisha sollën performancën e tyre përmes vallëzimit, derisa DJ Genti u përkujdes për muzikën gjatë tërë mbrëmjes.

PUNËTORIA “TERAPI ARTI”

Arti si terapi është shfrytëzuar për të prekur emocionalisht e shpirtërisht 10 pjesëmarrëse në punëtorinë e 18 shtatorit “Terapi Arti” të drejtuar nga artistja Mjellma Goranci Firzi , psikologia Kaltrina Ajeti dhe trajneri Visar Shehu. Ato qëndruan së bashku për disa orë, duke ndarë e përjetuar momente të veçanta drejt njohjes me njëra-tjetrën, e mbi të gjitha njohjes së vetes.

Pjesëmarrëset arritën që përmes pikturimit dhe lojërave të tjera relaksuese të shprehin emocionet e ndrydhura ndër vite. Kjo llojshmëri aktivitetesh e ndërthurur me art iu dha forcë të shprehin shqetësimet, por edhe vullnetin që të solidarizohen ndërmjet veti, duke gjetur qetësinë dhe motivin për të përqafuar realitetin.

Ky aktivitet u përmbyll me krijimin e pikturave nga përvojat dhe përjetimet e secilës prej tyre.

PERFORMANCA KORALE “TI JE ARSYEJA E DIKUJT PËR TË BUZËQESHUR”

Kori i Grave “Okarina” më 29 tetor, 2022 në Pallatin e Rinisë solli performancën “Ti je arsyeja e dikujt për të buzëqeshur”.

Këngë korale, lexime poezish dhe interpretime të tjera në piano, trumbetë dhe violonçel ishin dedikim për gratë dhe vajzat e prekura nga kanceri i gjirit, e gjithashtu për familjet dhe të afërmit e tyre. Energjia pozitive e koristeve, të cilat pasion e kanë muzikën, e përmbushën mbrëmjen me llojllojshmëri të këngëve, që përveç fuqizimit kishin edhe qëllimin e promovimit të vlerave artistike të këngëve që janë trashëgim nga artistë të ndryshëm kosovarë, hite që i kanë mbijetuar kohës.

Përveç, Korit “Okarina” të udhëhequr nga solokëngëtarja, Elikona Hysaj-Shala, performoi edhe kori i grave nga Peja “Canta Peja”. Artistet Meli Qena, Rina Kaçinari, Eriona Krasniqi, Eleonida Elezi, Dea Bajrami, dhe Mjellma Ibrahimi pasuruan këtë natë me interpretimet e tyre.

EKSPOZITA DHE MBRËMJA POETIKE “GRATEFUL”

Më 4 nëntor, 2022 në Shtëpinë e Evropës në Prishtinë ka zënë vend ekspozita dhe mbrëmja poetike “GRATEful”, nga artistet Donjeta Abazi dhe Besa Kica.

Në muret e Shtëpisë së Evropës ishin varur rreth 20 piktura të Besa Kicës në teknika, forma e kolorit të ndryshëm. Teksa ekspozita ishte hapur u lexuan edhe poezitë e Donjeta Abazit nga artisti Kushtrim Asllani.

“GRATEful” erdhi si mirënjohje për të gjitha gratë që janë revoltuar e kanë inspiruar gjeneratat për liri e barazi.

MBRËMJA POETIKE “PAR FUMÉ”

Me datë 12 nëntor 2022, në ambientet e KultPlus Caffe Gallery, është mbajtur mbrëmja poetike “Par Fumé”.

Kjo mbrëmje u organizua nga aktorët Armend Zeqiri dhe Florist Bajgora.

Poezi të përzgjedhura nga autore gra, për gratë, kanë sjellë emocion e përjetim tek të pranishmit, të cilët nuk ishin aty vetëm për të dëgjuar. Në bazë të një përzgjedhje të rastësishme poezitë morën zë dhe formë nga audienca, sepse ishin ata/ato që lexuan pjesën më të madhe të poezive.

SHFAQJA “RRËFIMET E GRAVE”

Teatri Dodona më 30 nëntor, 2022, u “shndërrua” në morg. “Rrëfimet e Grave” të vdekura u ngjallën para publikut, për të shpërfaqur shtypjen e shumëfishtë të grave nga patriarkati.

Vrasjet, dhunimet, dhe shtypjet e shumëfishta të grave ndër vite u ndërthurën në shfaqjen me regji të Tansu Kervan. Një grua, “kufomë e gjallë” - pastruese dhe larëse e kufomave të morgut, dhe e vetmuar në luftën e saj për mbijetesë, flet e qan hallet e saj me “shoqërueset” e vetme në punën e saj – gratë e vrara të patriarkatit.

E mërzitur me rrëfimin e jetës së saj, pastruesja kërkon nga të vdekurat që të rrëfejnë për jetën dhe arsyen e vdekjes së tyre. Ky është momenti i thyerjes së realitetit dhe fuqisë së teatrit. Një histori sa tronditëse aq edhe e guximshme shpaloset nga njëra prej të vdekurave. Jeta e një gruaje, një prostitute, një nëne, një vajze që patriarkati i ka marrë fëmijërinë duke e martuar të mitur, teksa i ka vrarë fëmijën, dhe në fund edhe vet atë.

“Rrëfimet e Grave”, të gjalla a të vdekura kanë një gjë të përbashkët – shtypjen nga patriarkati. Është një shfaqje që të godet emocionalisht e intelektualisht. Është një grusht i fuqishëm kundër secilës shtypje e pabarazi ndaj grave gjatë shekujve, e thirrje për ç’lirim nga patriarkati.

Kjo shfaqje, produksion i Teatrit “Nexhip Menekshe”, është prezantuar në gjuhën rome, me titra shqip.

AKTIVIZMI FEMINIST

Me protesta, marshe, konferenca, trajnime, punëtori, akte guerile e publikime të ndryshme Artpolis është angazhuar për barazi gjinore, dhe ngritje të kapacitetit të grave dhe vajzave dhe kundërshtim të sistemit patriarkal.

MARSHOJMË S'FESTOJMË

Nën sloganin "Nji e ardhme më e mirë është e mundshme", vajza e gra, burra e djem zaptuan sheshe e rrugë në thirrjet plot solidaritet, organizim e rezistencë në marshin e 8 Marsit "Marshojmë S'festojmë".

Marshimi kishte nisur tek Pallati i Drejtësisë ku u kërkua drejtësi për gratë e vrara dhe u kundërshtua patriarkalizmi i institucionalizuar. Marshi kumboi deri te sheshi "Zahir Pajaziti", ku morëm edhe më tej forcë për të vazhduar e për t'i denoncuar të gjitha institucionet përgjegjëse për vrasjet e grave, dhunën sistematike e padrejtësitë e shumëfishta.

#BOLL MA! ABUZIMI NUK FSHEHËT BRENDA MUREVE

Foto: Esad Duraki

Për herë të parë një marsh që thërret kundër abuzimit të grave me aftësi të kufizuara. Një hapësirë dedikuese për personat me aftësi të kufizuar, për të cilët ishte një përvojë dhe aktivitet i domosdoshëm.

Marshi "#BollMa" u mbajt më 8 dhjetor 2022 në sheshet e Prishtinës nën moton "#Boll Ma! Abuzimi nuk fshehët brenda mureve" në kuadër të Fushatës Botërore "16 Ditët e Aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore".

"Boll Ma!..." ishte një thirrje për të ndaluar abuzimin ndaj grave brenda e jashtë mureve, në hapësira publike e private. Mosraportimi, heshtja dhe fshehja e rasteve riprodhon strukturat e patriarkatit.

"Boll Ma!..." synoi të jetë zëri i revoltës që tenton të sfidojë e dënojë mizogjeninë, racizmin, seksizmin, diskriminimin, abuzimin dhe dhunën në të gjitha format e saj. Ky marsh u organizua në bashkëpunim të ngushtë me 10 organizata/institucione për persona me aftësi të kufizuara: Organizata e Personave me Distrofi Muskulore e Kosovës, HandiKos Drenas, HendiFer, Klubi Dëshira, HandiKos Prishtina, HandiKos Peja, HandiKos Theranda, Down Syndrome Kosova (DSK), So Kosovo, dhe Qendra Burimore për Mësim dhe Këshillim "Përparimi".

16 DITËT E AKTIVIZMIT KUNDËR DHUNËS ME BAZË GJINORE

Artpolis organizoi 16 aktivitete për të shënuar Fushatën Botërore “16 Ditët e Aktivizmit” të përbërë nga shfaqje teatrore, video feministe, marsh, shkolla pranverore feministe, rrjetëzim, dokumentar dhe punëtori.

E rrënjosur në pabarazitë e pushtetit midis grave dhe burrave, dhuna me bazë gjinore prek në mënyrë disproporcionale gratë dhe vajzat. Është një nga shkeljet më të përhapura dhe të vazhdueshme të të drejtave të njeriut në të gjithë botën, dhe në të shumtën e rasteve mbetet e paraportuar për shkak të mosndëshkimit, neglizhencës, heshtjes, stigmës dhe “turpit” që e rrethon.

Dhuna me bazë gjinore nuk është gjithmonë fizike ose seksuale, ajo mund të jetë gjithashtu psikologjike dhe ekonomike, duke përfshirë dhunën e partnerit/es, dhunën seksuale, gjuhën e urrejtjes, ngacmimin seksual e kibernetik, trafikimin e qenieve njerëzore, gjymtimin gjenital, femicidin dhe martesën e fëmijëve.

Me art dhe aktivizëm sfiduam qëndrimet që përjetësojnë, racionalizojnë dhe normalizojnë dhunën dhe mohojnë të drejtat e grave.

Në këto aktivitete morën pjesë 843 persona, kurse më shumë se 160,000 njerëz u arritën përmes mediave sociale.

ME VIDEO FEMINISTE PËR EMANCIPIM SHOQËROR

Më 1-5 dhjetor, 2022 Artpolis ka publikuar pesë video feministe në kuadër të Fushatës Botërore “16 Ditët e Aktivizmit”.

Kjo fushatë online u realizua me synimin për të rritur vetëdijen dhe për të avokuar për barazi gjinore dhe të drejtat e grave. Ngjarje të vërteta dhe rrëfime erdhën nën interpretimin e Trupës Artistike Rezidente të Artpolis, në bashkëpunim me stafin e Artpolis.

Përmes videove “FenoMen”, “Besoj në Vete”, “Maskuliniteti Toksik”, “Mes Lirisë dhe Kaosit”, “ReAct” trajtuam tema e çështje të rëndësishme sociale për shoqërinë tonë; ngacmimet seksuale, bullizmin, maskulinitetin toksik, përdhunimet e fenomene të tjera të dëmshme shoqërore.

KONFERENCA DHE PUBLIKIMI I RAPORTIT “GJINIA DHE MARRËDHËNIET E PUSHTETIT”

Foto: Rilind Beqa

Më 20 qershor, në kuadër të FemArt 10 në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës u mbajt konferenca dhe publikimi i raportit “Gjinia dhe Marrëdhëniet e Pushtetit- #Metoo në Arte: nga Thirrjet tek Ndryshimi Strukturor”, me autore Marta Keil (IETM), Katie Kheriji-Watts (OTM), që trajtoi situatën në lidhje me seksizmin, ngacmimin, ngacmimin seksual, dhe abuzimin me pushtetin në botën e artit evropian.

Ky aktivitet u hap nga presidentja e Kosovës, shkëlqesia e saj, dr. Vjosa Osmani – Sadriu, e cila dha një mesazh inspirues për të pranishmit dhe ndjekësit e rrjeteve sociale të FemArt, duke theksuar se secili hap drejt barazisë gjinore ka rëndësinë e vet, dhe të gjithë duhet të angazhohemi për një gjë të tillë.

“Ju falënderoj që nëpërmjet artit keni përzgjedhur që të përçoni mesazhe të rëndësishme për shoqërinë tonë dhe që nëpërmjet kësaj përpjekje e keni në qendër të vëmendjes pikërisht fuqizimin e grave dhe vajzave. Për mua dhe për gjithë zyrën time është nder që t’iu mbështesim sadopak në këtë rrugëtim, prandaj jam e sigurt se bashkëpunimi ynë do të intensifikohet çdo ditë e më shumë. Në luftën kundër pabarazive, kundër gjuhës së dhunës, abuzimit seksual, ngacmimit seksual, përdhunimit, paragjykimeve e padrejtësive si rezultat i mosbalancit në aspektin e pushtetit, dhe gjithnjë do të na keni në krah”, është shprehur Osmani.

Bashkë-autorja e Raportit, Katie Watts, bëri prezantimin e gjetjeve paraprake të raportit dhe rekomandimeve. Aktiviteti vazhdoi me dy panele diskutimi: “Ne duhet të flasim: Seksizmi dhe ngacmimi seksual në botën e artit”, si dhe “Krijimi i hapësirave të punës dhe vendeve të punës më të sigurta të artit”.

Siguria në punë dhe ambienti i sigurt për të menduar, vepruar e angazhuar janë të rëndësie të veçantë për të gjithë artistët.

KONFERENCA “REPREZENTIMI I BARABARTË NË TEATËR”

Foto: Esad Duraki

Në kuadër të Festivalit Ndërkombëtar të Teatrit në Ambient të Hapur - Prizrenfest u organizua Konferenca “Reprezentimi i barabartë në Teatër – Mundësitë dhe realiteti për aktoret dhe aktorët”.

Panelistët prezentë në këtë konferencë ishin figura eminente të skenës teatrore dhe përfaqësues institucionalë.

Diskutimi u zhvillua edhe mbi studimin e publikuar nga Konventa Evropiane e Teatrit (ETC) në Ditën Ndërkombëtare të Gruas më 8 mars 2021. Ky studim tregon pabarazitë gjinore, përkatësisht dominimin e burrave në teatër. Tregon se gratë kanë më pak siguri në kontrata dhe janë të pranishme në profesione stereotipike të grave dhe më pak të pranishme në krye të hierarkisë. Me këtë rast, kjo konferencë vuri në pah shqetësimet e artisteve të cilat po të njëjta janë edhe në Kosovë.

KURSI I VETËMBROJTJES “ÇIKAT E SJELLSHME”

Mbrojtja institucionale në të gjitha format e saj nuk mund të reagojë gjithmonë në kohë reale kur ndodhin sulme dhe shkelje të mundshme, veçanërisht në rastet kur sulmet janë të paplanifikuara dhe në hapësira të pafrekuentuara. Ekspozimi i vazhdueshëm i vajzave dhe grave ndaj kërcënimeve në hapësirat private apo publike kërkon mobilizim për minimizimin e këtyre rasteve, duke përdorur alternativat më efikase.

Përveç goditjes psikologjike që vajzat dhe gratë mund të përjetojnë nga sulmet fizike dhe seksuale ndaj tyre, njohuritë e grumbulluara dhe praktikuara nga ligjërimet, trajnimet dhe kurset e vetëmbrojtjes mund të ndikojnë në shmangien e këtyre situatave duke fituar kohë për t’u larguar nga skena ose duke kërkuar ndihmë nga institucionet e sigurisë. Kurset e vetëmbrojtjes mund të shihen si arritje e balancimit të gjendjes emocionale, mendore dhe fizike të viktimave, të cilët mund të reagojnë më shpejt në këto situata.

Në një shoqëri të dominuar nga burrat, siguria e vajzave dhe grave vazhdon të mbetet shqetësim, dhe kjo nuk është ndryshe as në shoqërinë kosovare.

Prandaj, për herë të parë në Kosovë Artpolis ka organizuar me sukses kursin e parë të vetëmbrojtjes “Çikat e Sjellshme”. Përgjatë dy muajve, qershor-korrik, 25 gra të reja të moshës 18-25 vjeçare nga Prishtina, Peja, Obiliqi dhe Gjilani, dhe nga komunitete në ndryshme përfunduan 28 sesione të kursit të vetëmbrojtjes “Çikat e Sjellshme”. Ato ushtruan nga tri herë në javë në Akademinë e Arteve Marciale në Prishtinë, bazuar në programin e vetëmbrojtjes të përgatitur dhe të zbatuar nga mjeshtri i Taekwondos, Nuhi Gashi.

Ky kurs shërbeu për këto vajza të ndërtojnë aftësitë vetëmbrojtëse, vetëbesimin, përmirësimin e shëndetit fizik dhe mendor. 25 vajzat kanë mësuar tetë teknika të vetëmbrojtjes për të shmangur sulmet e përkohshme fizike me rrezikshmëri të lartë, si; sulmet, tendencat e dhunimit, kidnapimit etj.

Kursi “Çikat e Sjellshme” ka përmiresuar edhe aspektin emocional të tyre. Duke pasur mundësi që të mbrojnë veten ka bërë që ato të kenë qëndrueshmëri dhe vetëbesim më të lartë për të performuar edhe në fushat e tjera të jetës.

Pas përfundimit të kursit këto 25 vajza u certifikuan në Akademinë e Taekwondos për nivelin e parë të vetëmbrojtjes.

Demonstrimi publik i “Çikave të Sjellshme” - Disa javë pasi kishin filluar kursin e vetëmbrojtjes “Çikat e Sjellshme” dëmonstruan para publikut aftësitë e tyre më 23 qershor, në kuadër të edicionit të dhjetë të Festivalit FemArt.

Demonstrimi publik, i udhëhequr nga trajneri Nuhi Gashi, u realizua në korridorin e Teatrit Kombëtar të Kosovës. Ky aktivitet u ndoq nga rreth 40 personave në audiencë, dhe nga më shumë përmes rrjeteve sociale dhe mediave.

14 vajzat e përfshira në demonstrimin publik kishin tejkaluar stresin dhe frikën për t’u paraqitur para publikut për shkak të metodave për menaxhim të emocioneve të mësuara gjatë kursit.

Grupi i dytë i kursit të vetëmbrojtjes “Çikat e Sjellshme” - Më 15 shtator, 2022 kishte nisur trajnimet e vetëmbrojtjes grupi i dytë i vajzave. Edhe në grupin e dytë 25 vajza morën pjesë në programin e vetëmbrojtjes.

Ato ndoqën sesionet e kursit të vetëmbrojtjes deri më 23 nëntor, 2022 nën udhëheqjen e trajnerit Nuhi Gashi, për t’u certifikuar më pas për nivelin bazik të vetëmbrojtjes.

Trajnimi i avancuar në kursin e vetëmbrojtjes “Çikat e Sjellshme” - Përveç nivelit bazik programi i kursit të vetëmbrojtjes kishte edhe nivelin e avancuar, atë të trajnimit të trajnereve. Ky nivel target kryesor kishte vajzat që dëshmuan përkushtim dhe potencial përgjatë kursit të nivelit bazik.

Dhjetë vajza u zgjodhën për të vazhduar me nivelin e avancuar të kursit të vetëmbrojtjes. Në procesin e përzgjedhjes pati rëndësi edhe shtrirja gjeografike e vajzave, jo vetëm aftësia e tyre, në mënyrë që ky kurs potencialisht të ketë shtrirje edhe në qytetet e tjera të Kosovës në të ardhmen.

Rrjetëzimi i kursit “Çikat e Sjellshme” - Në kuadër të Fushatës Botërore “16 Ditët e Aktivizmit” Artpolis organizoi një ngjarje rrjetëzuese me vajzat pjesëmarrëse në kursin e vetëmbrojtjes “Çikat e Sjellshme”.

Më 25 nëntor, 2022 kjo ngjarje bëri bashkë vajzat e kursit me nxënës të shkollës fillore “Iliria” në Prishtinë. Vajzat ndanë përvojat, njohuritë dhe teknikat e mësuara të vetëmbrojtjes me nxënës/e të kësaj shkolle, duke ofruar një pasqyrë të rëndësisë që kanë aktivitete të tilla për shëndetin fizik, psiqik dhe emocional.

DOKUMENTARI BIBA MAY – “JO MË”

Më 9 dhjetor, 2022 është dhënë premiera e filmit dokumentar Biba May – “Jo Më” në Kino Armata. Kurse më 10 dhjetor është prezantuar në Pejë, në Kino “Jusuf Gërvalla” duke përmbyllur aktivitetet e Artpolis në kuadër të Fushatës Botërore “16 Ditët e Aktivizmit”.

Shkruar dhe prodhuar nga Shqipe Malushi, producente ekzekutive dhe drejtim artistik të Zana Hoxhës, dhe regji të Arlinda Morinës, dokumentari Biba May – “Jo Më” është një histori e fuqizimit të grave me aftësi të kufizuara dhe një model guximi, vendosmërie, përkushtimi dhe dashurie! Në premierën e tij personalitete të shumta vendore dhe ndërkombëtare ishin prezent në Kino Armata, përfshirë këtu edhe ministrin e kulturës, Hajrulla Çeku.

Rrëfimi i Resmije Rahmanit, e njohur si Biba, emocionoi të gjithë të pranishmit. Biba, e cila vuan nga distrofia muskulore progresive, me gjithë sfidat, pengesat dhe humbjet e saj, nuk ndaloi kurrë duke u përpjekur të bëjë ndryshimin për personat me aftësi të kufizuara.

Mbi 250 persona ishin prezent në këto dy prezantime të dokumentarit.

DHJETË TRAJNIME “EDUKIMI I GRAVE TË REJA MBI FEMINIZMIN”

Trajnimi “Edukimi i grave të reja mbi feminizmin” sivjet kishte nisur me qytetin e Mitrovicës, për të vazhduar me Podujevën, Gjakovën, Graçanicën, Ferizajn, Prishtinën, Pejën, Hanin e Elezit, Dragashin, dhe Kaçanikun.

Ky trajnim ka bërë bashkë **191 vajza dhe gra** me moshë, etni dhe profesione të ndryshme.

Ligjëruese e këtyre trajnimeve ishte aktivistja dhe feministja Liridona Osmanaj, e cila ka ligjëruar për termet feministe, valët e feminizmit, lëvizjet e fushatat feministe, si dhe format e mënyrat që vajzat mund të ndjekin për t’u fuqizuar, e të fuqizojnë të tjerat. Në këto trajnime kanë zënë vend edhe kuizet dhe lojërat e tjera argëtuese përmes së cilës mësimi feminist ishte bërë edhe më kuptimplotë.

Në trajnimin e feminizmit në Graçanicë për vajzat e komunitetit serb kanë ligjëruar aktivistet Nevenka Rikalo dhe Gordana Toskić.

Vlen të theksohet trajnimi me 15 gra dhe vajza me aftësi të kufizuara i mbajtur më 27 shtator në Prishtinë. Një trajnim përmbajtësor dhe mundësi shumë e mirë për këto gra që të shprehin vështirësitë dhe sfidat, por edhe mundësitë që kanë për të përmirësuar jetën e tyre në një shoqëri patriarkale.

ADRESIMI I NGACMIMEVE SEKSUALE

Gjatë vitit 2022 Artpolis ka vazhduar me intensitet edhe më të lartë angazhimin për adresimin e ngacmimeve seksuale, me theks të veçantë në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”.

Përmes sesioneve informuese, takimeve e publikimeve të ndryshme jemi angazhuar për ngritje të vetëdijes, veçanërisht në raportimin e rasteve të ngacmimeve seksuale.

Pas miratimit të “Rregullores kundër Ngacmimeve Seksuale brenda Universitetit të Prishtinës” Artpolis ka ndihmuar Universitetin në implementimin e saj.

ARTPOLIS ASISTON UNIVERSITETIN E PRISHTINËS NË ZBATIMIN E RREGULLORES

Më 18 janar, 2022 Artpolis është ftuar në takim me Rektorin e Universitetit të Prishtinës, Naser Sahiti, si dhe me zyrtaren për parandalim dhe adresim të ngacmimeve seksuale, Drita Hyseni, për të diskutuar rreth hapave të mëtutjeshëm në implementimin e Rregullores.

Në komunikim dhe takime të vazhdueshme me zyrtaren Drita Hyseni, Artpolis ka përpiluar një plan të veprimit dhe e ka propozuar tek Universiteti i Prishtinës më 15 prill, 2022.

Gjatë këtij viti Universiteti i Prishtinës ka treguar gatishmëri të lartë që në bashkëpunim me Artpolis të organizohen sesione informuese, fushata, dhe punëtori apo trajnime të ndryshme.

Ky angazhim bën që studentët dhe stafi administrativ dhe akademik i Universitetit “Hasan Prishtina” të përfitojnë direkt nga mundësitë e krijuara për raportimin e ngacmimeve dhe ngacmimeve seksuale.

Më 2022 katër persona kanë raportuar rastet e ngacmimeve seksuale në Universitetin e Prishtinës.

PËRDITËSIMI DHE SHPËRNDARJA E BROSHURËS "NGACMIMET SEKSUALE NË KOSOVË"

Më 2022, pas kërkesës nga Universiteti i Prishtinës, Artpolis ka përditësuar dhe adaptuar broshurën "Ngacmimet Seksuale në Kosovë", specifikisht për Universitetin në adresimin e ngacmimeve seksuale. Në broshurën e përditësuar janë shtuar edhe informacionet mbi Rregulloren, si dhe format që duhet të ndiqen për ta raportuar ngacmimin seksual brenda Universitetit të Prishtinës.

Qëllimi i broshurës ishte që të rriste vetëdijen për format diskriminuese dhe jodiskriminuese të ngacmimit në Universitetin e Prishtinës. Gjithashtu, kjo broshurë mbulon tema të tilla si identifikimi i sjelljeve të ngacmimit seksual, si ta raportohet dhe ku të kërkohet ndihmë nëse besoni se mund të jeni duke përjetuar ngacmim.

Broshura iu shpërnda studenteve/ëve të të gjitha fakulteteve gjatë sesioneve informuese të mbajtura nga Universiteti i Prishtinës dhe Artpolis.

PËR HERË TË PARË MBAHEN NË UP 14 SESIONE INFORMUESE PËR ADRESIMIN E NGACMIMEVE SEKSUALE

Universiteti i Prishtinës në bashkëpunim me Artpolis – Qendra për Art dhe Komunitet së bashku me zyrtaren për parandalimin dhe mbrojtjen nga ngacmimi dhe ngacmimi seksual, Drita Hyseni, kanë mbajtur 14 sesione informuese për adresimin e ngacmimeve dhe ngacmimeve seksuale më 12-27 tetor, 2022.

Hyseni dhe përfaqësuesja e Artpolis, Diellza Bezera-Dana, menaxhere e projekteve, i kishin informuar studentet/ët për "Rregulloren kundër Ngacmimeve Seksuale brenda Universitetit të Prishtinës", mënyrës së raportimit të rasteve dhe ruajtjen e konfidencialitetit pas raportimit. Gjithashtu, kishin diskutuar se çka është ngacmimi seksual, format e ngacmimit seksual si dhe sjelljet të cilat konsiderohen ngacmim seksual.

Këto sesione informuese u realizuan në të gjitha Fakultetet e Universitetit të Prishtinës, përfshirë atë: Filozofik, FSHMN, Filologjik, Juridik, Ekonomik, FIEK, FIM, FNA, Mjekësi, Arte, FBV, FEFS, Edukim dhe Arkitekturë.

AKTI GUERIL “MOS HESHT”

Me datë 18 nëntor, 2022 në sheshin e qytetit të Prishtinës u dëgjuan tinguj violonçeli e thirrje për siguri të vajzave e grave.

Performanca “Mos Hesht” erdhi si akt gueril. Frika që ngacmimet në rrugë shkaktojnë, ditën apo natën, është një realitet për shumë vajza dhe gra.

Ngacmimet dhe ngacmimet seksuale janë kërcënime në rrugë që sjellin vazhdimisht pasiguri e frikë për vajzat e gratë. Andaj, Artpolis përmes kësaj performance në rrugë u bëri thirrje të gjitha vajzave e grave të raportojnë rastet e ngacmimeve seksuale.

GRATË PËR PAQE

Angazhimi i grave dhe vajzave për paqe dhe siguri në Kosovë dhe rajon ka vazhduar edhe sivjet. Në solidaritet me njëra-tjetrën gratë artiste dhe aktiviste kanë bashkuar forcat në aktivitete të ndryshme për të njohur njëra-tjetrën, për të kuptuar sfidat dhe për t'u bërë bashkë kundër shtypjes, pabarazive dhe diskriminimit etnik, klasor, gjinor dhe racor.

ARTPOLIS PËRMBYLL FORUMIN E GRAVE, PAQES DHE SIGURISË TË ORGANIZUAR NGA PRESIDENTJA OSMANI

Foto: Esad Duraki

Edicioni i parë i Forumit të Grave, Paqes dhe Sigurisë, organizuar nga Zyra e Presidencës, ishte përmbyllur më 23 tetor, 2022 me dy aktivitete të Artpolis në Klan Arena.

Paneli i diskutimit "Roli i grave artiste në ndërtimin e paqes" dhe shfaqja teatrore "Toka e Shpirtrave të Trazuar" u prezantuan në ditën e fundit të këtij Forumi, iniciativë e shkëlqesisë së saj Dr. Vjosa Osmani Sadriu, Presidente e Republikës së Kosovës. Artiste dhe aktiviste të shquara ishin pjesë e panelit të diskutimit që u moderua nga drejtorja ekzekutive dhe themeluesja e Artpolis dhe Festivalit FemArt, Zana Hoxha.

Aktivistja kroate Rada Borić, kuratorja dhe themeluesja e Manifesta, Hedwig Fijen, artistja dhe aktivistja Ema Andrea, aktorja dhe regjisorja Maja Mitić, si dhe regjisorja dhe dramaturgia Blerta Zeqiri ishin pjesë e këtij paneli. Ato ritheksuan rëndësinë, ndikimin dhe rolin që luajnë arti dhe aktivizmi. Sipas tyre kur arti prezantohet dhe krijohet nga gratë atëherë është edhe më afër shoqërisë. Secila prej tyre ka qenë dëshmitare e ndikimit të artivizmit të tyre. Me ngjarjet dhe përjetimet e tyre ato inspiruan dhe motivuan të pranishmit që të merren edhe më shumë me art, ose ta mbështesin atë.

Shfaqja teatrore "Toka e Shpirtrave të Trazuar", me autore Shqipe Malushi dhe regji të Zana Hoxhës, u prezantua pas panelit të diskutimit. Personalitete të shquara të politikës, artit dhe kulturës ishin prezent në këto aktivitete, përfshirë edhe presidenten Vjosa Osmani-Sadriu dhe mysafiret e nderuara të Forumit.

SHKOLLA PRANVERORE FEMINISTE

Pjesa e parë e Shkollës Pranverore Feministe u zhvillua nën moton “Gratë e reja që ndërtojnë paqen”. 19 vajza nga Kosova dhe Serbia u bënë bashkë në një hapësirë të përbashkët dhe të sigurt nga data 30 mars – 2 prill 2022, në Prishtinë.

Gjatë katër ditëve të Shkollës u trajtuan tema të ndryshme, duke i angazhuar pjesëmarrëset në proceset praktike të të mësuarit dhe duke eksploruar më shumë për veten, të ardhmen e tyre feministe dhe procesin e ndërtimit të paqes.

“Rrugëtimi drejt njohjes së statusit të të mbijetuarve të dhunës seksuale nga lufta e fundit në Kosovë”, “historia e feminizmit në Kosovë”, “ligji dhe feminizmi”, “kontributi i grave në paqe dhe siguri”, “limitet tona personale” dhe “siguria feministe dhe ndërtimi i një lëvizje rezistente” ishin temat që pasuruan programin e pjesës së parë të Shkollës.

Emrat e njohur të aktivisteve dhe përfaqësueseve të institucioneve, përfshirë Ariana Qosaj-Mustafa, Linda Gusia, Donika Emini, Kadire Tahiraj, Yllka Soba dhe Nora Prekazi ligjëruan për temat e lartpërmendura.

Pjesa e dytë e Shkollës Pranverore Feministe, i mblodhi 18 gra të reja nga Kosova e Serbia në Vrnjačka Banjë/Serbi, nga datat 1-4 dhjetor 2022 në kuadër të “16 Ditëve të Aktivizmit”.

Ato patën rastin të mësojnë nga ligjëruesit Andrijana Kocić, Sanja Pavlović, Nađa Duhaček, Jadranka Miličević, Minja Bogavac, Selena Simić, Anita Dragosavac dhe Jelena Memet.

AKTIVIZMI I PERSONIFIKUAR DHE GUXIMI PËR TË PUSHUAR

Më 4-8 maj 2022, Artpolis organizoi takimin rajonal të komunitetit "Aktivizmi i personifikuar dhe guximi për të pushuar" që u mbajt në Frushka Gorë, Serbi.

Ky takim mblodhi 32 aktiviste nga rajoni, respektivisht nga Kosova, Serbia, Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Bosnja e Hercegovina, në një takim sa personal aq edhe kolektiv, që orientoi pjesëmarrëset drejt guximit, intimitetit dhe dinjitetit, në punë e sipër për të shëruar lidhjet e tyre – lidhjet e tyre që shërojnë.

Ideja për t'u mbledhur buroi pikërisht nga kjo kohë e Covid-19 që parashtroi kërkesa e biseda të reja dhe eksperimentonte rreth mënyrës se si ne përjetojmë, organizojmë, lidhemi, punojmë dhe jemi katalizatore të transformimit shoqëror përmes angazhimit për drejtësi.

AKTIVIZMI I PERSONALIZUAR PËR REFLEKTIM DHE PROSPERITET NË MES TË GRAVE TË BALLKANIT

15 vajza e gra të rajoneve, komuniteteve, kategorive dhe grupmoshave të ndryshme nga Kosova, Serbia, Shqipëria, Mali i Zi dhe Bosnja dhe Hercegovina morën pjesë në punëtorinë "Aktivizmi i personalizuar për reflektim dhe prosperitet në mes të grave të Ballkanit", që u mbajt më 4-7 nëntor, 2022.

Përmes kësaj punëtorie gratë dhe vajzat pjesëmarrëse tentuan të krijojnë një bazament të qëndrueshëm duke reflektuar mbi nevojat e tyre të paplotësuara dhe ndjenjat e shtypura ndër vite. Përtej punës dhe kontributit të vazhdueshëm në shoqëri, kthimi i fokusit nga vetja i dërgoi ato në një qasje më humane, empatike dhe shumëdimensionale në raport me vetveten. Kjo punëtori bashkoi gra e vajza të cilat i dhanë kuptim hapësirës së përbashkët duke përçuar tek njëra tjetra ndjenjën e sigurisë, paqes dhe dashurisë.

Facilitatore të këtij trajnimi ishin aktivistet dhe feministet Zana Hoxha, Yllka Soba dhe Shqipe Malushi.

MEDIA DHE ARTI NË SHËRBIM TË PAJTIMIT

Në kuadër të projektit “Media dhe Arti në Shërbim të Pajtimit”, nën udhëheqjen e organizatës partnere Kulturanova/Novi Sad dhe në partneritet me organizatën “Naša djeca“/Zenicë nga Bosnje e Hercegovina, Artpolis ishte pjesë e aktiviteteve në edicionin e 11-të të Festivalit Ndërkombëtar “Takt Fest”.

Ky festival zuri vend nga data 23-25 shtator, 2022 në Novi Sad të Serbisë.

“Të flasim për paqen në Takt 2022” ishte seksioni që përbëhej nga aktivitetet si: paneli diskutues “Roli i mediave dhe artit në procesin e pajtimit në Ballkanin Perëndimor”, ekspozita artistike e të rinjve nga Serbia, Kosova dhe Bosnja e Hercegovina dhe koncerti “Të shërohemi së bashku”.

Ky bashkëpunim ndihmoi në ndërtimin e paqes duke kujtuar të kaluarën dhe njëkohësisht duke shkëmbyer përvojat dhe kulturat. Në këtë formë gjithmonë duke dëshmuar se arti e kultura i tejkalon barrierat, thyen paragjykimet dhe ndërton urat e paqes.

REBELIMI NDAJ SHTYPJES DHE PABARAZISË

Angazhimi për liri dhe barazi vazhdon të mbetet i përditshëm, dhe do të mbetet i përhershëm. Sfidimi i patriarkatit ka vazhduar në forma e mënyra të ndryshme, online apo fizikisht, brenda apo jashtë institucioneve, veçanërisht aty ku kulmon rebelimi kundër secilës shtypje e pabarazie – në rrugë, të bashkuara.

Vrasësit, sulmuesit, ngacmuesit dhe dhunuesit e grave vazhdojnë të mos marrin dënimet e merituara. Ata cenojnë jetën e secilës grua a vajzë ditën e natën, në shtëpi e në rrugë. Kudo dhe kurdo që i shohin. Prandaj, burgimi i tyre është liri për gratë, dënimi i tyre është drejtësi për gratë.

Përmes protestave, marsheve dhe fushatave kemi bërë thirrje për drejtësi, barazi e emancipim shoqëror.

VRASJA E GRAVE NGA BURRAT TË TRAJTOHET SI URGJENCË KOMBËTARE

Më 1 dhjetor, aktiviste dhe aktivistë u mblodhën sërish në shesh dhe bllokuan rrugët e qendrës së Prishtinës për të kundërshtuar femicidin dhe alarmuar që vajzat e gratë anembanë Kosovës janë në rrezik.

Mes parullave, thirrjeve dhe zjarrit bërtitëm mllefin dhe dhimbjen për vrasjen e Hamide Magashit dhe fëmijës së saj të palindur nga vrasësi Sokol Haliti në oborrin e QKUK-së, më 30 nëntor. Përsëritëm që kjo vrasje makabre, e dyta me radhë për më pak se një javë, nuk u bë veç nga dora e vrasësit. Hamidja u vra nga Sokoli dhe nga shteti, i cili po i lë gratë pa siguri e pa mbrojtje edhe kur ato marrin guximin ta kërkojnë atë. E ndjera ishte nën urdhër mbrojtjeje nga vrasësi i saj në momentin kur ajo u qëllua. Pra, shteti ishte i paralajmëruar që në gusht të këtij viti që ajo mund të vritej por prapë e lejoi atë.

Vrasja e Hamides ishte femicid. Është vrasje e cila po alarmon që kjo shoqëri e ky shtet po mbahet mbi trupin e gjakun e grave. Gratë po vriten veç pse ato janë gra. Ato po vriten sepse ky sistem ende vazhdon t'i mësojë burrat që gratë janë pronë e tyre. Që ato janë nën burrat. Këtë po ua konfirmon çdo ditë shteti që i sheh gratë para së gjithash si dytësore në shoqëri.

Thërrasim në organizim dhe kërkojmë nga shteti dhe shoqëria që vrasja e grave nga burrat të trajtohet si urgjencë kombëtare. Siguria e grave të trajtohet si aspekt i sigurisë publike. Shteti dhe shoqëria të qëndrojnë me gratë e të mos lejojmë që dhuna dhe vrasjet e grave të kalojnë në çështje numrash.

Ky shtet e kjo shoqëri nuk mund të qëndrojë qetë përderisa jeta e grave është në rrezik të vazhdueshëm, përderisa vajzat e gratë çohen e flenë me frikë, nuk mund të ketë qetësi.

MBROJTJE PËR VAJZAT DHE GRATË

Më 5 shtator aktiviste u bashkuan në protestën "Mbrojtje për vajzat dhe gratë", pas rastit kur 5 djem dhe burra kishin përdhunuar një vajzë 11 vjeçare.

Dështimi institucional nuk mund të tejkalohej me dy shkarkime, dorëheqje e lojë fajësimesh mes institucionesh. Dhuna ndaj vajzave dhe grave është në nivele pandemike, andaj dhe luftimi i saj duhet të jetë urgjencë kombëtare.

Përdhunimit të vajzave dhe grave dhe mosfunksionimit të shtetit iu përgjigjëm me revoltë para institucioneve përgjegjëse.

Kërkesat e protestueseve ishin:

1. Legalizimin e përdorimit dhe shpërndarjen e gazit irritues për vetëmbrojtje (pepper spray)
2 Shkarkimin e zyrtarëve policorë përgjegjës për rastin e përdhunimit të së miturës;
3. Krijimi i një njësiti të specializuar për dhunë seksuale në Polici;
4. Siguri, drejtësi dhe rehabilitim për të mbijetuarat e dhunës seksuale dhe
5. Futjen e lëndës së edukatës seksuale në shkolla.

HOMOFOB S'KI VEND NË KUVEND!

Më 17 mars, 2022 aktiviste dhe aktivistë protestuan para Kuvendit të Kosovës për të shprehur pakënaqësitë ndaj neglizhencës dhe refuzimit për të shtyrë përpara të drejtat e njeriut, për të gjithë personat pa dallim, që janë të garantuara me Kushtetutën e Republikës.

Nën moton "Homofob S'ki vend në Kuvend" dhe parullat e shpalosura "Dashnia nuk është sëmundje", "Dashnia është rezistente", dhe "Me homofoba nuk ka shtet" u protestua kundër deputetëve dhe politikanëve që nuk respektojnë të drejtat e njeriut duke mos e miratuar ndryshimet në Kodin Civil, i cili do t'u hapte rrugë martesave mes personave të së njëjtës gjini.

PO TË GJITHA GRATË

Me datë 27 shtator, 2022, në ora 20:50, në qendër të qytetit të Pejës një burrë kishte sulmuar seksualisht alpinisten dhe aktivisten, Mrika Nikçi.

Guximi i Mrikës për ta raportuar dhe publikuar rastin na ka inspiruar që të guxojmë e të luftojmë kriminelët edhe ne, së bashku, derisa drejtësia e liria të arrihet.

Artpolis u solidarizua me Mrikën dhe të gjitha vajzat e gratë, viktima të dhunës seksuale, teksa iu ka bërë thirrje institucioneve të sjellin drejtësi për të gjitha gratë!

AKTORJA E ARTPOLIS DENONCON DHUNËN NDAJ NJË GRUAJE NË SHTËPINË E PLEQVE

Aktorja e Artpolis, Kaltrinë Zeneli, me guxim ka denoncuar dhunën ndaj një gruaje në Shtëpinë e Pleqve “Orenda” në Pejë. Në një video të publikuar nga Kaltrina shihen disa vajza duke ushtruar dhunë ndaj të moshuarës.

Ky rast përveç që ishte shqetësuese dhe e tmerrshme, shpërfaqi përbrendësimin e patriarkatit edhe tek disa gra. Prandaj, dënimi për gratë që ushtrojnë dhunë ndaj gruas së moshuar sipas ligjeve në fuqi është domosdoshmëri.

Artpolis, iu bëri thirrje institucioneve shtetërore që të sjellin drejtësi për secilën grua, për secilën viktimë të dhunës së burrave apo grave, pa dallim. Guximi i Kaltrinës na inspiron dhe motivon që të angazhohemi edhe më fuqishëm si organizatë për të drejtat e grave dhe grupeve të margjinalizuara.

Zërat kërcënues ndaj Kaltrinës vetëm sa na forcojnë bindjen se angazhimi kundër dhunës na sjell çdo ditë e më afër lirisë, drejtësisë dhe barazisë. Zmbrapsja për ne nuk është opsion, kurrë nuk do të jetë. Jemi këtu për t’i thënë stop dhunës, dhe po fuqizimit të grave dhe emancipimit shoqëror.

FUQIZIMI I TË RINJVE DHE TË REJAVE

Krahas aktivizmit artistik në thelb të misionit të Artpolis qëndron angazhimi për ngritjen e kapaciteteve të të rinjve dhe të rejave, përgatitje e artistëve/eve dhe aktivistëve/eve të rinj/reja. Ndarja e njohurive me ta, krijimi i një hapësire të sigurt për t'u shprehur, rritur, dhe fuqizuar është me rëndësi thelbësore për të sjellë ndryshime pozitive në shoqëri. Përmes trajnimeve, punëtorive dhe formave të tjera artistike Artpolis dhe Trupa Artistike Rezidente përcjellin entuziazmin, përkushtimin, disiplinën dhe inspirimin tek këta të rinj dhe të reja.

PËRGATITJA E ARTISTËVE/EVE PËR AUDICIONE

Foto: Rilind Beqa

Përgatitja maksimale dhe puna sistematike është ajo që e bën një artiste e një artist të trasojë rrugën drejt sukseseve. Në Teatrin Kombëtar të Kosovës 20 të rinj e të reja, kureshtarë për të mësuar, më 25 janar, 2022 ishin pjesë e trajnimit “Përgatitje për audicion”, të parin e këtij lloji në Kosovë.

Ata/ato mësuan mbi elementet më të rëndësishme të audicionit, paraqitjen para jurisë, mënyrën e qëndrimit, komunikimin, gabimet që duhet të shmangen, e mbi të gjitha shpërfaqja e talentit tyre brenda atyre pesë minutave jetikë të bashkëdyzuar me njerëzoren brenda tyre janë elemente thelbësore për një audicion të suksesshëm.

Për lëvizjet skenike, ecjen skenike, vallëzimin, funksionimin në grup, rëndësinë e frymëmarrjes, e gjetjen e qetësisë para një audicioni këta artistë e artiste u trajnuan nga koreografi Robert Nuha.

Kurse regjisorja Zana Hoxha, përveç rëndësisë që kanë përgatitja e poezisë, monologut e këndimit, i trajnoi këta të rinj mbi rëndësinë e të qenit artist, peshën e përgjegjësinë që kanë për të shënuar suksese, rëndësinë e integritetit personal e profesional. Për audicione muzikore ligjëroi pianisti Alzan Gashi, i cili përveç shpjegimit të termeve muzikore që artistët mund të hasin në një audicion e që kanë rëndësi të madhe, ka folur edhe për teknikat dhe format që artistët mund të përgatiten për një audicion muzikor.

ARTISTËT E RINJ PËRGATITEN PËR KRIJIM TË CV-SË DHE PORTFOLIOS

Me energjinë pozitive gjatë përgatitjes për audicione ka vazhduar edhe dita e dytë e projektit “Mbështetje për Artin dhe Artistët e Rinj në Kosovën e Post Covid” me trajnimin për dizajnim/krijim të CV-së dhe Portfolios.

Një CV dhe Portfolio e mirë përgatitur është ajo që mund të marrë vëmendjen e një jurie, apo punëdhënësi të caktuar. Ajo është pasqyra e parë e karrierës dhe punës së secilit, e dëshmisë së vazhdimësisë, por të gjitha elementet e shkruara duhet të mbrohen nga personi nëse pyeten për to. Element tjetër me rëndësi të veçantë ishte edhe diskutimi mbi referencat që artistët mund të marrin e duhet t’i kenë nga bashkëpunuesit e tyre. Në këtë trajnim ligjëruan Zana Hoxha dhe Elira Lluka.

PUNËTORIA “TEKNOLOGJIA DHE ARTI”

Foto: Rilind Beqa

Punëtoria “Teknologjia dhe Arti”, e mbajtur më 12 dhe 16 prill, me ligjërues Gazmend Ejupi dhe Liburn Jupollin, ka bërë bashkë 80 të rinj dhe të reja, profesorë universitarë e artiste/ë të rinj të fushave të ndryshme, dhe nxënës që synojnë të ndjekin ëndrrën e tyre në art.

Më 12 prill 2022, në Kampusin e UBT-së në Lipjan artisti Gazmend Ejupi me energjinë, pasionin e shkathtësinë komunikative krijoi interaktivitet të lartë, me pjesëmarrësit që treguan përkushtim gjatë tërë punëtorisë.

Vizatim kreativ, instalacion, pikturë, dizajn mode, fotografi, realitet virtual, dhe grafiti në hapësirat e UBT-së përthekuan këtë punëtori që pati 50 pjesëmarrës.

Kurse më 16 prill 2022 në Prishtinë është mbajtur punëtoria “Teknologjia dhe Arti” me ligjërues Liburn Jupollin. 30 artistë/e të rinj e të reja, pjesëmarrës të kësaj punëtorie, patën rastin të mësojnë mbi ekosistemin kulturor dhe skemat institucionale në Kosovë, mjetet e promovimit, dhe rëndësinë e jashtëzakonshme të rrjetëzimit; që ngriti pyetje të shumta e diskutime.

Çka është teknologjia? Çka është arti? Si ndërlidhen ato me njëra-tjetrën dhe profesionet e tjera? Për rëndësinë e artit dhe artistëve/eve në shoqëri, menaxhim të karrierës dhe mjetet që duhet shfrytëzuar për të korrur suksese ishin disa nga temat e mbuluara në këtë punëtori.

Krahas kësaj Jupolli shpalosi disa nga përvojat e tij më të rëndësishme e më inspiruese, duke i motivuar këta të rinj. Ai u fokusua në edukimin paraprak të artistëve, duke iu sugjeruar që çdo artistë të njohë botën e artit dhe esencën e saj, duke mësuar nga paraardhësit.

TRAJNIMI “EDUKIMI I BAZUAR NË TEATËR”

Në datat 25-27 shkurt u mbajt trajnimi “Edukimi i Bazuar në Teatër” me 20 të rinj e të reja nga qytete e komunitete të ndryshme të Kosovës, me trajnerë Lulzim Bucolli dhe Edlir Gashi.

Aftësia për të portretizuar temat sociale në një mënyrë shumë vizuale dhe për të ofruar një kontekst për informacionin e dhënë, identifikohet si një pikë e fortë e Edukimit të Bazuar në Teatër.

Vullneti i të rinjve për të mësuar e për të marrë sa më shumë prej këtyre sesioneve bëri që trajnimi të mbyllet me plotë dashuri, energji pozitive dhe miqësi të reja dhe të vlerësohet nga të rinjtë si një eksperiencë e paharruar.

TRAJNIMI I PROGRAMIT TË FORUM TEATRIT I BASHKOI TË RINJTË/REJAT E KOMUNITETEVE

16 të rinj dhe të reja ishin pjesëmarrës në trajnimin e programit të Forum Teatrit, me ç'rast morën mësimet bazike të teknikave teatrale në qytetin e Prizrenit, që shquhet për diversitet kulturor.

Edukim mbi teatrin dhe të drejtat e njeriut, aktrim, lojëra relaksuese, diskutime, ushtrime fizike, improvizime, e shumë aktivitete tjera i përmbushën katër ditët e trajnimit, më 11 –14 shkurt 2022. Zana Hoxha dhe Qendresa Kajtazi mentoruan këta të rinj dhe të reja gjatë këtij trajnimi.

"Kam mësuar mbi të gjitha çka është forum teatri, aftësi të shumta aktrimi, se nuk është e nevojshme të flasësh për të thënë diçka", thotë një nga pjesëmarrësit në trajnim.

TRAJNIMI I PROGRAMIT TË FORUM TEATRIT BASHKON KOMUNITETIN SHQIPTAR DHE SERB

18 vajza e djem nga komunitetet shqiptare dhe serbe kanë qenë pjesë e Trajnimi të Programit Forum Teatër të mbajtur më 15-18 prill, 2022 në Durrës, Shqipëri.

Të mentoruar nga artistët Zana Hoxha dhe Edlir Gashi pjesëmarrësit kanë pasur rastin të mësojnë shumë gjëra rreth teatrit, lëvizjeve skenike, gjuhës së trupit, dhe mbi të gjitha të komunikuarit përmes shfaqjeve forum teatër.

Pjesëmarrësit arritën të shijojnë edhe plazhin gjatë zhvillimit të aktiviteteve (meditim, trajnim dhe argëtim), duke krijuar një lidhje të ngushtë me natyrën dhe me njëri-tjetrin. Për të thyer barrierat e paragjykimet dhe duke i bërë që të reflektojnë mbi jetën e tyre, ishin në gjendje t'i ndajnë përvojat e tyre me njëri-tjetrin me sinqeritet.

Diversiteti kulturor ishte pikë e rëndësishme e trajnimit, ku pjesëmarrësit u inkurajuan të flasin gjuhën amtare secili, duke ua siguruar përkthimin simultant, dhe në këtë mënyrë të shkëmbenin kulturat, përvojat e përjetimet. Edhe më të veçantë këtë trajnim e ka bërë diversiteti i grupit të të rinjve/rejave. Ata/Ato ishin të moshave e profesioneve të ndryshme; nxënës/e, student/e, mësimdhënës/e, biznesmen/e, polic/e dhe jurist/e të moshës nga 16-31 vjeç.

FËMIJË DHE TË RINJ/REJA MËSOJNË PËR BARAZINË GJINORE ME ARTISTEN SELMA SELMAN

Sa më i hershëm kuptimi i barazisë gjinore, aq më shumë përbrendësohet angazhimi për barazi e drejtësi. Më 2 tetor, 2022 të rinj/reja dhe fëmijë kanë pasur rastin të mësojnë më shumë mbi barazinë gjinore duke përdorur edhe artin si mjet. Punëtoria "Barazia Gjinore" e drejtuar nga artistja Selma Selman, bëri bashkë fëmijët e moshës 7-14 dhe të rinjtë/rejat e moshës 14-18, të cilët u argëtuan dhe shprehën talentin e tyre.

Njëherësh, ata/ato kanë diskutuar e mësuar mbi rolet dhe stereotipet gjinore. Pjesë e kësaj punëtorie ishin komuniteti shqiptar, rom, ashkali dhe egjiptian, të cilët shprehën ëndrrat e dëshirat e tyre për të ardhmen.

Punëtoria u përmbyll me krijimin e vizatimeve, pikturave e sloganeve për barazi gjinore nga pjesëmarrësit/et, që vuri në pah talentin dhe kreativitetin e tyre. Kjo punëtori u organizua nga Artpolis – Qendra për Art dhe Komunitet në mbështetje të Asamblesë Qytetare të Helsinkit, Banja Lluka.

THEMELOHEN PESË KLUBE TEATRORE, PREZANTOHEN NËNTË SHFAQJE FORUM TEATËR

Gjatë vitit 2022 Artpolis ka themeluar **pesë klube teatrore**, derisa ka prezantuar **nënt**ë **shfaqje forum teatër** në qytete të ndryshme të Kosovës me **11 repriza** në total. **82 të rinj dhe të reja** ishin pjesë e këtyre Klubeve, dhe performancat e tyre u ndoqën nga më shumë se **725 persona në audiencë**.

Më 3 shkurt, 2022 është formuar klubi teatror në **Mitrovicë** me 17 vajza e djem nga shkollat e mesme të këtij qyteti. Me ta kanë punuar aktorët e Trupës Artistike Rezidente, Edlir Gashi dhe Mikel Markaj.

Një ditë më vonë, më 4 shkurt, 2022 ishte themeluar Klubi Teatror në **Fushë Kosovë** me 12 të rinj dhe të reja nga komunitetet pakicë Romë, Ashkali dhe Egjiptian. Aktoret e Trupës së Artpolis, Qendresa Kajtazi dhe Donikë Ahmeti kanë punuar me ta përreth dy muaj.

Kurse më 5 maj, 2022 është themeluar Klubi Teatror në **Vushtrri** me 12 të rinj dhe të reja, mentor i të cilëve ka qenë aktori Ismail Kasumi.

Në muajin shtator Artpolis ka themeluar dy klube teatrore; në **Ferizaj** (14 shtator), si dhe **Gjakovë** (20 shtator).

15 të rinj dhe të reja ishin pjesë e Klubit në Ferizaj, me të cilët punuan aktorët Qendresa Kajtazi dhe Edlir Gashi. Kurse në Gjakovë me 26 të rinj dhe të reja punuan Blerta Gubetini dhe Shpëtim Selmani.

Gjithashtu me këto klube punuan edhe koreografi Robert Nuha, pianisti Alzan Gashi dhe regjisorja e drejtoresha e Artpolis, Zana Hoxha.

SHFAQJA “EDHE SA ROMEO TË TJERË”, KUNDËR NGACMIMEVE SEKSUALE NË SHKOLLA

Më 7 shkurt, 2022 të rinjtë dhe të rejat e Klubit Teatror SHFMU “Nazim Gafurri” nga Prishtina, kanë prezantuar **shfaqjen forum teatër “Edhe sa Romeo** të tjerë”, duke kërkuar që ngacmimet seksuale në shkolla të mos ndodhin, por mbi të gjitha ato të raportohen.

Skena humori, përplasje e rivalitet ndërmjet personazheve ishin ndërthurur në këtë shfaqje që u prezantua në Amfiteatrin e Fakultetit të Arteve në Universitetin e Prishtinës.

Nën mentorimin e aktoreve të Trupës Artistike Rezidente të Artpolis, Kaltrinë Zeneli dhe Zhaneta Xhemajli këta të rinj e të reja sollën me mjeshtëri para publikut këtë shfaqje mbi ngacmimet seksuale në shkolla, duke prekur kështu ndikimin që kanë tek fëmijët veprimet e mosveprimet e personave përgjegjës. Ngjarja zhvillohet në hapësirat e shkollës dhe jashtë saj. Përgatitjet për një shfaqje teatrore me personazhe kryesore Romeo dhe Zhulieta dështojnë. Gjithçka shkon keq kur Ylli, që është përzgjedhur të luaj rolin e Romeos, zhduket dhe nuk vjen më në shkollë për shkak të ngacmimeve seksuale që ia ka bërë pikërisht arsimtarja që po e përgatit këtë shfaqje. Pas zhdukjes së shokut të tyre nxënësit dalin edhe në protesta duke kërkuar drejtësi dhe gjetjen e Yllit.

Pas përfundimit të shfaqjes rreth **60 persona në publik** patën rastin të bëjnë pyetje për personazhet rreth trajtimit të kësaj shfaqje.

SHFAQJA “JETA MË PËRKET MUA” NDËRTHUR SHANTAZHIN DHE BULLIZMIN KIBERNETIK

Më 30 mars, 2022 të rinjtë dhe të rejat e qytetit të Mitrovicës dhanë premierën e **shfaqjes forum teatër “Jeta më përket mua”** në Teatrin e Qytetit “Muharrem Qena”.

Të përgatitur nga aktorët e Trupës Artistike të Artpolis, Edlir Gashi e Mikel Markaj, ata/ato trajtuan temën shantazhit dhe bullizmit kibernetik.

“Jeta më përket mua” sjell narrativen e një vajze të re. Si përballet ajo me shantazhet, bullizmin kibernetik, dhe keqpërdorimin e teknologjisë. Cila është pesha e reagimit shoqëror dhe institucional në raste të tilla?!

Pas shfaqjes, **publiku në përbërje të mbi 110 personave** pati mundësinë të parashtrojë pyetje personazheve, duke përçuar mesazhin se shantazhi është krim, e kjo dukuri duhet të ndalet. Viktimat duhet të mbështeten në këtë luftë, dhe shantazhuesit të përballen me drejtësinë.

SHFAQJA “UNË JAM PASURI” RRËFIM DASHURIE QË SFIDON RACIZMIN

Inspiruar nga një ngjarje e vërtetë, më 01 prill, 2022 është prezantuar **shfaqja forum teatër “Unë jam pasuri”** në Amfiteatrin e Fakultetit të Arteve. Të rinjtë dhe të rejat e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian nga Fushë Kosova me guxim kanë goditur racizmin, paragjykimet, stereotipet e normat shoqërore përmes shfaqjes “Unë jam pasuri”.

Një rrëfim dashurie ndërmjet një vajze rome dhe një djali shqiptar shpërfaq mendësinë patriarkale e racizmin që është i shprehur në shoqërinë kosovare. Për ta dallimet etnike dhe barrierat që vendosin familjet e shoqëria janë një absurd, por janë të bindur se së bashku mund të arrijnë të dëshmojnë se dashuria tejkalon barrierat e etnisë, racës a fesë.

Pas shfaqjes një diskutim aktiv u bë me publikun, që parashtruan pyetje të shumta e komentuan mbi situatat e dallimet që mund të kemi. Me këta të rinj për dy muaj kanë punuar aktoret e Trupës Artistike Rezidente të Artpolis, Qendresa Kajtazi dhe Donikë Ahmeti.

Kjo shfaqje u prezantua edhe më 6 maj 2022 në Fushë Kosovë. Në këto dy prezantime ishin prezent **85 persona në audiencë**.

SHFAQJA “LE T’NDRYSHOJMË!”, SI THIRRJE KUNDËR RACIZMIT

Artpolis – Qendra për Art dhe Komunitet në kuadër të Koalicionit të Kosovës për Pajtim, prezantoi shfaqjen “Le t’ndryshojmë!” në Amfiteatrin e Stacionit Hekurudhor të Fushë Kosovës, më 13 qershor 2022.

Ngjarja zhvillohet në hapësirat shkollore, ku një djalë nga komuniteti rom bullizohet nga shoqja e tij e klasës, përderisa mësimdhënësja nuk reagon.

Ajo vazhdon mësimin duke injoruar atë se çka po ndodhë në klasë. Por, jo të gjithë janë racistë sepse Drini ka një shoqe që e mbron dhe e fuqizon. Edhe Dea përqeshet nga shoqëria, por kjo nuk e ndalon atë të jetë në anën e drejtë dhe të luftojë për të drejtat e barabarta. “Le t’ndryshojmë!” vjen si thirrje për të luftuar racizmin e paragjykimet. Të bashkuar për të ndryshuar botën.

TË RINJTË NGA VUSHTRRIA SHFAQIN TALENTIN SHUMËDIMENSIONAL

Më 15 qershor, 2022 në Kalanë e Vushtrrisë të rinjtë dhe të rejat e këtij qyteti kanë prezantuar **performancën "Shpirtrat Pështpërisin".**

Një natë e mbushur me energji, entuziazëm e pasion për artin vajza e djem nga Vushtrria interpretuan poezi të ndryshme, monolog, këndim, kitarë e violinë. Derisa nuk munguan edhe artistët e rinj të artit pamor, që prezantuan pikturat e tyre. Publiku, përveç që pati rastin të argëtohet me një mbrëmje të poezisë dhe këndimit, ishte dëshmitar i talentit të piktoreve/ëve që krijuan piktura gjatë kohës sa ndodhte performancat.

Këta të rinj dhe të reja u trajnuan nga aktori i Trupës Artistike Rezidente të Artpolis, Ismail Kasumi, i cili udhëhoqi edhe programin e performancës "Shpirtrat Pështpërisin", i cili u ndoq nga më shumë se **70 persona në audiencë**.

SHFAQJA “EKLIPS” ME MESAZH KUNDËR DHUNËS NDAJ GRAVE

Më 3 gusht, 2022 u dha premierë **shfaqja forum teatër “Eklips”** në Amfiteatrin e Fakultetit të Arteve në Universitetin e Prishtinës.

“Eklips” erdhi si një rrëfim skenik mbi dhunën, kërcënimet e vrasjen e grave. Përmes lojës skenike, tekstit e performancës muzikore të rinj e të reja ngritën vetëdije, duke adresuar e kundërshtuar dhunën seksuale, fizike, psiqike e emocionale ndaj grave.

Në këtë shfaqje u ndërthurën trishtimi, vetmia, çlirimi, dashuria, gëzimi, argëtimi, shqetësimi e pasiguria për t’i dhënë emocione të shumta publikut. Këta të rinj dhe të reja sollën këtë shfaqje për ta tronditur që të reflektojë mbi rolin që institucionet, familja, e miqtë luajnë në ngjarjet e dhunës, që nuk duhet të qëndrojnë të izoluara e brenda hapësirës private.

Pas përfundimit të shfaqjes, **publiku** në përbërje të 60 personave pati rastin të parashtrojë pyetje të shumta për personazhet e të japë komente e këshilla për temën e trajtuar. Një debat i gjerë, aktiv dhe i thellë u realizua ndërmjet publikut dhe personazheve duke përçuar mesazhin se dhuna nuk duhet të tolerohet, e shtypja ndaj grave duhet të marrë fund.

SHFAQJA FORUM TEATËR "...EDHE MUA" ME DY PREZANTIME

Me datë 26 shtator, 2022 në Teatrin e Qytetit të Gjakovës "Hadi Shehu", u prezantua **shfaqja forum teatër "...Edhe Mua"**, me të rinjtë e të rejat e qytetit të Shtimes. Pas reprizës në Gjakovë shfaqja udhëtoi drejt qytetit të Gjilanit, me datë 27 shtator, 2022 ajo u prezantua në Shtëpinë e Rinisë.

"... Edhe Mua" është një dramë e llojit forum teatër që trajton temën e dhunës seksuale, traumat që pëson viktima në ballafaqimin e saj me shoqërinë, krizat emocionale e psikologjike.

Pas përfundimit të shfaqjes, nën facilitimin e aktores Blerta Gubetini, publiku pati rastin të diskutojë me personazhet kryesore rreth temës së trajtuar në shfaqje.

Këto dy prezantime u ndoqën nga **50 persona në audiencë.**

SHFAQJA “VALLËZO PA FRIKË”, ME MESAZHE KUNDËR NGACMIMEVE SEKSUALE

Më 8 nëntor, 2022 në Teatrin “Adriana” në Ferizaj u dha premierë **shfaqja forum teatër “Vallëzo pa frikë”** në prani të më shumë se **150 personave në audiencë**.

Ngacmimet e sulmet seksuale nuk duhet të zënë vend në shoqërinë tonë. Viktimat duhet të mbështeten nga institucionet e shoqëria, kurse kriminelët e kanë vendin në burg. Ky ishte mesazhi që përçoi shfaqja forum teatër “Vallëzo pa frikë”.

Të rinjtë dhe rejat e Klubit Teatror në Ferizaj, që punuan nën mentorimin e aktorëve të Trupës Artistike Rezidente të Artpolis, Qendresa Kajtazi dhe Edlir Gashi, patën një paraqitje të shkëlqyer skenike, për çka edhe i morën duartrokitjet e publikut gjatë gjithë kohës.

Ngjarja kryesore zhvillohet në shkollë kur tri vajza me pasion për vallëzimin ngacmohen seksualisht gjatë sesionit të provave. Kjo ngjarje lë gjurmë të rënda tek secila prej tyre, megjithatë të tria reagojnë në forma të ndryshme ndaj kësaj ngjarje – me dyshime, frikë e guxim. Shumëçka varet edhe nga reagimi i shoqërisë dhe i familjes kur ngjarja bëhet publike në mediumet e vendit.

SHFAQJA “ANOTHER BRICK IN THE WALL”, MBI ANKTHIN E NXËNËSVE NË SHKOLLË

Më 16 nëntor, 2022 në Teatrin “Hadi Shehu” në Gjakovë u prezantua **shfaqja forum teatër “Another Brick in The Wall”**, e cila u ndoq nga **140 persona në audiencë.**

“Another Brick in The Wall” përcolli mesazhe të fuqishme për ankthin e nxënësve në shkolla të shkaktuar nga një pjesë e mësimdhënësve indiferentë ndaj kësaj dukurie.

Raportet mësimdhënës/e – nxënës/e duke qenë se janë raporte të pushtetit, domosdoshmërisht ndërveprojnë edhe shumë elemente të tjera duke ndikuar kështu në gjendjet e ndryshme emocionale si ankthi, pasiguria e parehatia tek nxënësit brenda objekteve shkollore, dhe jo vetëm. Ngacmimi seksual, presioni psiqik dhe mosvlerësimi i përkushtimit dhe gatishmërisë së nxënësve u pasqyruan po ashtu përmes kësaj shfaqje forum teatër.

Të rejat dhe të rinjtë e Klubit Teatror në Gjakovë, që punuan nën mentorimin e aktorëve të Trupës Artistike Rezidente të Artpolis, Blerta Gubetini dhe Shpëtim Selmani, treguan një paraqitje skenike mahnitëse, gjë që u bë e dukshme edhe përmes duartrokitjeve dhe entuziazmit të publikut të treguar gjatë gjithë kohës.

Pas përfundimit të shfaqjes një debat aktiv është zhvilluar ndërmjet personazheve dhe publikut, duke u ritheksuar kështu nevoja për reforma sa i përket qasjes ndaj nxënësve, metodologjisë së përdorur, vetëdijesimit dhe raportimit të dhunës e ngacmimeve seksuale.

NGRITJA E KAPACITETEVE TË STAFIT TË ARTPOLIS

Përgjatë vitit 2022 stafi i Artpolis ka mbajtur trajnime dhe punëtori, si individuale ashtu edhe grupore. Në mesin e tyre janë edhe punëtoritë e organizuara nga vet Artpolis.

PLANIFIKIMI STRATEGJIK DHE MEL

Më 19-21 shkurt, 2022 stafi i Artpolis ka mbajtur trajnimin “Planifikimi Strategjik dhe Përditësimi i Mjeteve të Monitorimit, Vlerësimit dhe Mësimit (MEL)” në Durrës.

Përveç punës së palodhshme në zyret e Artpolis, kësaj radhe planifikimi strategjik në kuadër të përgatitjes së Strategjisë së re të Artpolis, planet e punës për vitin 2022 dhe prezantimi i metodave të reja për monitorim dhe vlerësim u vendosën dhe u diskutuan në qytetin e Durrësit.

Puna vazhdoi duke hartuar Planin e Punës për vitin 2022, si dhe duke prezantuar Strategjinë e Marrëdhënieve me Publikun, si dhe Teorinë për Ndryshim. Gjatë këtyre tre ditëve stafi i Artpolis kishte diskutuar dhe kishte filluar punën për përgatitjet e edicionit të 10-të të Festivalit FemArt.

NGRITJA E KAPACITETEVE TË ARTISTËVE/EVE DHE AKTIVISTËVE/EVE TË ARTPOLIS

Më 29-31 gusht, 2022 në Valbonë është mbajtur punëtoria për ngritjen e kapaciteteve të Trupës Artistike dhe stafit të Artpolis.

Punëtoria u hap me "Adresimin e ngacmimeve seksuale" nga drejtoresha ekzekutive e Artpolis, Zana Hoxha dhe menaxherja e projekteve, Diellza Bezera. Përveç prezantimit të broshurave, publikimeve dhe arritjeve të deritanishme është diskutuar gjerësisht për hapat që Artpolis do të ndërmarrë në adresimin dhe parandalimin e ngacmimeve seksuale.

Në këtë punëtori është bërë edhe monitorimi dhe vlerësimi i edicionit të dhjetë të Festivalit FemArt, me ç'rast janë diskutuar sfidat dhe mësimet e nxjerra, ndryshimet që duhet bërë për të rritur edhe më shumë kualitetin e Festivalit dhe ndikimin në shoqëri. Në ditën e dytë të punëtorisë ka zënë vend diskutimi mbi Strategjinë e re të Artpolis, të cilën e drejtuan trajnerët Shqipe Malushi e Kushtrim Shaipi. Paralelisht me diskutimet mbi strategjinë e re, në një hapësirë tjetër, Trupa Artistike Rezidente e Artpolis ka bërë përgatitjet muzikore nën drejtimin e kompozitorit Liburn Jupolli.

Punëtoria është mbyllur në ditën e tretë nga Trupa Artistike dhe stafi i Artpolis me planifikimin e detajuar të aktiviteteve për pjesën e mbetur të vitit 2022.

STAFI DHE TRUPA E ARTPOLIS DISKUTOJNË MBI STRATEGJINË 2023-2027

Më 25 tetor, 2022 në Pejë është mbajtur punëtoria rreth Strategjisë së re të Artpolis 2023-2027. Punëtoria u hap me diskutimet rreth strategjisë së re të Artpolis nga drejtoresha ekzekutive, Zana Hoxha dhe menaxherja e projekteve, Diellza Bezera.

Stafi dhe Trupa Artistike Rezidente e Artpolis kanë diskutuar e komentuar rreth strategjisë së re dhe planeve afatgjate të organizatës, duke përditësuar synimet dhe angazhimet që do t'i ketë organizata në vitet e ardhshme.

Poashtu, u diskutua për realizim e edicionit të 11-të të Festivalit FemArt.

VIZITAT DHE BASHKËPUNIMET E REJA

Ky vit ka shënuar ndër rritjet më të rëndësishme të Artpolis, në aspektin e zgjerimit të bashkëpunimeve të reja dhe ndërtimit të partneriteteve.

BUÇAJ SPONSOR GJENERAL I ARTPOLIS

Artpolis – Qendra për Art dhe Komunitet që si synim ka krijimin e një shoqërie feministe dhe të barabartë duke avokuar dhe përdorur artin si mjet për ndryshim social, në vitin 2022 pati edhe një aleat të fuqishëm që beson në vlerat e njëjta, korporatën Buçaj Sh.P.K.

Përmes Ligjit për Sponsorizim korporata Buçaj ka mbështetur aktivitetet e Artpolis gjatë vitit 2022, duke u bërë sponsori gjeneral i organizatës. Përmes kësaj përkrahje ndikimi në komunitet është rritur.

Përveç përgjegjësisë për mirëqenien e punëtorëve të saj Buçaj Sh.P.K ka dëshmuar se përkrahja e komunitetit mund të bëhet në forma e në mënyra të ndryshme, veçanërisht në përkrahjen e vajzave dhe grave, të rinjve e të rejave që angazhohen në aktivitetet e Artpolis.

BASHKËPUNIMI FRANCEZ

Profesionistë të teatrit dhe kulturës nga Kosova qëndruan për tre ditë në Avignon për t'u njohur nga afër me një nga festivalet më prestigjioze në Francë dhe në botë - Festival D'Avignon.

Me ftesë të Ambasadës së Francës, pjesë e delegacionit prej shtatë profesionistësh të kulturës nga Kosova, ishin edhe dy përfaqësueset e Artpolis, Zana Hoxha, themeluese dhe drejtoreshë, si dhe Venera Ismaili, zyrtare e projekteve.

Përveç si një përvojë e veçantë kjo vizitë shërbeu edhe si mundësi për të njohur artistë/e ndërkombëtarë/e dhe për të krijuar bashkëpunime të reja.

ZANA HOXHA LAUREATE E ÇMIMIT “LIDERET E SË ARDHMES” NGA FRANCA

E nominuar nga Ambasada e Francës në Kosovë, Zana Hoxha është nderuar nga shteti francez për angazhimin e saj për barazi gjinore, ngritjen e vetëdijes, emancipim shoqëror dhe të drejtat e grave.

Zana, e cila është regjisore teatri dhe drejtore e Artpolis dhe Festivalit FemArt, qëndroi në Francë nga 25-30 shtator, 2022 me ç’rast ndau përvojën e saj me personalitete të shquara franceze, por edhe mësoi më shumë mbi diplomacinë feministe franceze.

“Gjatë qëndrimit të saj, ajo tregoi një përkushtim të palëkundur, që iu bëri përshtypje bashkëbiseduesve me angazhimin në punën e saj në Kosovë për barazi dhe për të luftuar kundër çdo lloj diskriminimi dhe dhune ndaj grave”, thuhet në letrën e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Francës.

Përveç takimeve dhe diskutimeve mbi barazinë gjinore dhe feminizmin, ajo pati një pritje speciale nga institucione shtetërore dhe organizata jo qeveritare në Francë.

ZANA HOXHA VIZITOI “ISRA-DRAMA: EKSPOZIMIN NDËRKOMBËTAR TË TEATRIT IZRAELIT”

Me ftesë të Ambasadës së Izraelit në Kosovë drejtorja ekzekutive dhe themeluesja e Artpolis dhe Festivalit FemArt, Zana Hoxha, ishte prezent në një nga ngjarjet më të mëdha kulturore të këtij shteti “Isra-Drama: Ekspozimi Ndërkombëtar të Teatrit Izraelit”.

Gjatë qëndrimit pesë ditor në Izrael, 16-20 nëntor 2022, Hoxha pati mundësi të shohë performanca të ndryshme, të takojë artiste/ë dhe të njohë nga afër skenën e pasur teatrore të Izraelit. Një mundësi shumë e mirë për të krijuar bashkëpunime me skenën teatrore izraelite, dhe jo vetëm.

“Isra-Drama” është një ngjarje e dizajnuar për të ekspozuar teatrin izraelit para komunitetit ndërkombëtar të teatrit: drejtorëve të festivaleve, drejtorëve të teatrove, drejtorëve artistik, dramaturgëve, regjisorëve, dhe gazetarëve.

Kësaj vizite të Zana Hoxhës në Tel Aviv i kishte paraprirë edhe një takim me ambasadoren e Izraelit në Kosovë, Tamar Ziv, në zyret e Artpolis.

ARTPOLIS NË PARTNERITET ME PRIZRENFEST

Qendra për Art dhe Komunitet – Artpolis gjatë vitit 2022 ka filluar bashkëpunimin me Festivalin Ndërkombëtar të Teatrit në Ambient të Hapur – Prizrenfest.

Prizrenfest, që mbahet në qytetin e Prizrenit, sivjet organizoi edicionin e parë, nga 31 korrik deri më 4 gusht, dhe Artpolis kontribuoi me tri aktivitete: Shfaqjen “Ora e Vdekjes”, shfaqjen “Zgjimi i Pranverës”, si dhe konferencën “Reprezentimi i barabartë në Teatër - Mundësitë dhe realiteti për aktoret dhe aktorët”.

SHKËMBIMET KULTURORE ME ARTISTË/E

Më 9 dhjetor, 2022 drejtorë/e të teatrove, regjisorë/e dhe artistë/e u mblodhën në punëtorinë "Shkëmbimet Kulturore" për të diskutuar, shkëmbyer ide dhe të ndajnë përvojën e tyre në botën e artit. Kjo punëtori, e drejtuar nga regjisorja dhe drejtoresha ekzekutive e Artpolis, Zana Hoxha dhe Diellza Bezera, menaxhere e projekteve në Artpolis, ishte realizuar në kuadër të Fushatës "16 Ditët e Aktivizmit kundër Dhunës me Bazë Gjinore".

Gjatë punëtorisë u diskutuan dhe u dhanë rekomandime të ndryshme mbi praktikat më të mira për teatrot kosovare. U diskutua mbi ndërgjegjësimin, diversitetin, komunikimin dhe ndjeshmërinë kulturore, si dhe ndarjen e praktikave më të mira personale dhe profesionale në shkëmbimet kulturore me qëllim ndërtimi dhe zgjerimi të marrëdhënieve me vendet tjera të rajonit dhe botës.

STUDENTË/E NGA VJENA DHE VENECIA NJOFTOHEN ME PUNËN E ARTPOLIS

Më 16 dhe 17 shtator, 2022 studentë/e nga Vjena dhe Venecia, patën rastin të njoftohen me aktivizmin artistik të Artpolis – Qendrës për Art dhe Komunitet dhe Festivalit FemArt.

Në Teatrin ODA , drejtoresha dhe themeluesja e Artpolis dhe Festivalit FemArt, Zana Hoxha, prezantoi para tyre punën dhe aktivitetet e Artpolis ndërvite. Kurse në zyrën e Artpolis këta të rinj dhe të reja takuan edhe Trupën Artistike Rezidente të Artpolis, me të cilët diskutuan për angazhimin e tyre artistik, në krijimin e shfaqjeve profesionale dhe punën në komunitet.

ARTPOLIS ME KOMUNITET TË ZGJERUAR

Artpolis në vazhdimësi angazhohet në zgjerimin e komunitetit të saj, respektivisht rritjen e angazhimit të Anëtarësisë dhe zgjerimin e saj. Tashmë Artpolis numëron 72 anëtare/ë, prej tyre 50 gra dhe 22 burra, dhe është në rritje gjithnjë e më shumë.

BLLOGJET

Për t'i dhënë publikut një përjetim të veçantë të aktiviteteve të FemArt 10 janë përkujdesur aktivistet, Ivana Bilić nga Bosnja dhe Hercegovina, dhe Alba Ajdarevikj nga Kosova. Ato kanë sjellë 11 bllogje. Kurse dy bllogje ka shkruar aktivistja Mimozë Musliu.

"Toka e Shpirtrave të Trazuar", nga Ivana Bilić: https://bit.ly/3Okvdue

"Arti i Argëtimit dhe Kënaqësia e të Jetuarit" nga Ivana Bilić: https://bit.ly/3tlovGG

"Toka dhe Një Histori Njerëzore" nga Ivana Bilić: https://bit.ly/3xJq74l

"Gratë: Trupat, Shpirtërorja dhe Përkushtimi" nga Ivana Bilić: https://bit.ly/3bbuJbC

"Kosova, Toka e Shpirtrave të Trazuar - edhe Njëzet Vjet më Pas" nga Alba Ajdarevikj: https://bit.ly/3ypgU2l

"Burrneshat – Zgjedhje Për të Jetuar apo Konstrukt Shoqëror" nga Ivana Bilić: https://bit.ly/3yB1dFm

"Fuqia e Artit në Ndryshimin e Jetëve dhe Fillimin e Revolucioneve" nga Ivana Bilić: https://bit.ly/3P9SXC1

"Qytetet Natën - Një Ecje për të Mposhtur Frikën" nga Ivana Bilić dhe Alba Ajdarevikj: https://bit.ly/3RrKWdv

"Trupi im është Toka e Vetme që Zotëroj" nga Ivana Bilić: https://bit.ly/3PnzDBr

"Unë Nuk Jam Tepih - Nuk do t'i Lë Njerëzit të Ecin Mbi Mua" nga Ivana Bilić: https://bit.ly/3zpOCW7

"Emocione Goditëse në Ditën e 10-të të Festivalit Femart" nga Ivana Bilić: https://bit.ly/3RVF2Id

"Drama "Top Girls", për gratë e pushtetshme" nga Mimozë Musliu: shorturl.at/gmuQW

"#Boll Ma! Abuzimi nuk fshehët brenda mureve" nga Mimozë Musliu: shorturl.at/hACGM

VLERËSIMI DHE MONITORIMI

Vlerësimi dhe Monitorimi i aktiviteteve është bërë përmes prezencës së mediave, pyetësorëve, numrit të pjesëmarrësve dhe ndjekësve, formularëve të vlerësimit dhe intervistave.

SFIDAT DHE MËSIMET E NXJERRA

Mungesa e Hapësirave – Një nga problemet më të shpeshta është edhe mungesave e hapësirave, veçanërisht tek realizimi i veprave artistike në kuadër të Fondit për Art Feminist. Mungesa e hapësirave ka bërë që aktivitetet të shtyhen deri në gjetjen e hapësirës dhe kohës së përshtatshme të prezantimit të veprës.

Vonesa në përgjigjet në aplikimet tona për fonde dhe/ose vonesë në transferimin e fondeve nga donatorët - Këtë vit, vonesa në përgjigjet ndaj aplikimeve tona për grante për donatorët, konkretisht për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe për Komunën e Prishtinës, ka shkaktuar probleme në organizimin e Festivalit FemArt. Nga ana tjetër, vonesa në transferet e fondeve që u konfirmuan nga donatorë të tjerë e thelloi këtë problem. Në vend që gjithë energjia dhe forca e stafit të Artpolis të kanalizohej në organizimin e Festivalit FemArt, duhej shpenzuar për gjetjen e zgjidhjeve të menjëhershme financiare, në mënyrë që asnjë nga aktivitetet të mos dështonte. Edhe pse u krijua një situatë mjaft sfiduese, Artpolis arriti të mbulonte shpenzimet e aktiviteteve.

Kalimi i kufijve – Një nga sfidat gjatë FemArt ishte ndalimi i trupës së aktorëve të shfaqjes “Burrat” nga Portugalia në kufirin Kroaci-Serbi. Ata nuk arritën të sjellin skenografinë dhe rekuizitat e shfaqjes, të cilat ishin të vendosura në një kamion, me arsyetimin se i kishin për qëllime komerciale, jo artistike. Pavarësisht përpjekjeve tona dhe sigurimit të dokumenteve shtesë, ata nuk arritën të kalojnë kufirin. Edhe pse një situatë mjaft stresuese për trupën e shfaqjes dhe stafin e Artpolis të përfshirë në organizimin e kësaj shfaqjeje, megjithatë ata arritën në Kosovë dhe Artpolis e përshtati shfaqjen me skenografi të re në bashkëpunim me Teatrin Kombëtar të Kosovës.

Greva në Arsim – shtyrja një mujore e fillimit të vitit shkollor ka pasur ndikim edhe në aktivitetet e Artpolis, duke zvogëluar qasjen direkte tek të rinjtë dhe të rejat për pjesëmarrje në aktivitetet e Artpolis, respektivisht njoftimit të tyre për mundësinë që të jenë pjesë e aktiviteteve tona. Megjithatë, bashkëpunimi me institucione dhe organizata joqeveritare lokale ka qenë efikas për njoftimin e të rinjve të rejave për pjesëmarrje.

Kriza Ekonomike – ngritja e madhe e çmimeve të produkteve të ndryshme në tregun tonë, si rezultat i situatës së krijuar në nivel global nga lufta në Ukrainë, padyshim se ka prekur edhe mbarëvajtjen e projekteve të Artpolis. Respektivisht, inflacioni ka prekur buxhetet e projekteve të ndryshme të Artpolis, pasi që disa nga planifikimet tona të mëhershme buxhetore nuk ishin reale me ato të tregut. Megjithatë, deri më tani, i kemi realizuar të gjitha aktivitetet e planifikuara, duke përdorur marrëdhëniet e mira që i kemi me ofrues të ndryshëm produktesh e shërbimesh dhe duke përdorur negocimin e çmimeve si një mjet për realizimin e aktiviteteve tona pa lejuar ndikimin e çmimeve reale të tregut.

Mosardhjet e konfirmuara në aktivitete – Një nga sfidat me të cilat jemi përballur është edhe mbledhja e pjesëmarrësve në aktivitete, respektivisht anulimin apo mosardhjen në aktivitete përkundër konfirmimit. Hezitimi për të qenë pjesë e trajnimeve, si dhe rëndësia që këto trajnime kanë në ngritjen e vetëdijes dhe rritjes së aktivizmit feminist na motivon dhe do të na shërbejë si mësim që të realizojmë sa më shumë aktivitete në këto komunitete për emancipim shoqëror.

ÇFARË THONË TË TJERËT PËR ARTPOLIS

“Përveç leksioneve të vetëmbrojtjes ky kurs (Çikat e Sjellshme) më ndihmoi shumë edhe në aspektin e kondicionit fizik por edhe atij mendor. Vetëbesim më i lartë, energji e mirë e një komunitet shumë i mirë. Faleminderit Artpolis dhe gjithashtu instruktorit të Taekwondo-së, Nuhi Gashi. E mos t’harrojmë që edhe çikat munden me dal kur të duan e ku të duan”, Fjolla Vllasaliu.

“Është hera e tretë që vij në Serbi, dhe çdo herë dikush nga rrethi im do të më quante tradhtare sa që herën e parë kam pas dyshime nëse kam vepruar mirë. Tani që jam këtu prapë, përmes Shkollës Pranverore Feministe jam duke u ndjerë mirë dhe unë e di se do të ndikoj në shoqërinë time duke iu treguar se vendi dhe njerëzit janë shumë të mirë, për dallim nga ato që jemi mësuar të dëgjojmë nëpër media”, Jeta Kurtaj.

“Për mua ka qenë shumë e rëndësishme me qenë pjesë e Klubit Teatror, për shkak se qaty e kam pa veten se përnjëmend mundem me bo diçka, dhe e dua aktrimin. Kemi kaluar shumë mirë me Trupën Artistike të Artpolis, ata na kanë qenë aty për gjithçka që kemi pasur nevojë. Gjatë shfaqjes kam kaluar shumë mirë, personalisht kam mësuar shumë gjëra të reja, të cilat nuk besoj se do të mund t’i mësoja diku tjetër. Ka qenë një mundësi shumë e mirë për ne dhe për këtë dua ta falënderoj Artpolis-in”, Arbesa Azemi.

“Kurrë në jetë nuk e kam menduar se do të shkoj në Serbi, por kur e pranova thirrjen e sfidova veten të shkoj dhe të shoh se çfarë lidhje kanë vajzat serbe me neve. Më herët unë i kam paragjykuar shqiptarët kur kanë pasur shoqe e shokë serbë, por tani gjatë FSS-së kam ndërruar mendje”, Sidorela Sylmetaj.

“Sa i përket kursit Çikat e Sjellshme mendoj se kjo ka qenë një ndër përvojat më të mira që kam pasur. Tani e ndjej veten më të sigurt, si në rrugë dhe në jetën e përditshme, jam më e fort mentalisht dhe fizikisht”, Eljesa Xhini.

“Kur njerëzit neve na pyesin se çka jeni duke bërë dhe qysh po mendoni se 20 gra të reja, për një vit do të ndërtojnë paqen me Kosovën. Ne nuk jemi duke e ndërtuar paqen me Kosovën, ne vetëm po krijojmë hapësirë për respekt dhe mirëkuptim. Ne po krijojmë hapësira për vajzat më të reja, ashtu siç kanë krijuar hapësira aktivistet përpara nesh. Faleminderit të gjithave dhe pushtoni ato hapësira sa më shumë që mundeni”, Andrijana Kocić nga organizata partnere nga Serbia “Qendra Alternative e Vajzave”.

“Gratë gjithmonë kanë nevojë për fuqizim pavarësisht faktit se çdo ditë po mundohen të bëjnë diçka për të. Gruan e shoh të fuqizuar vetëm atëherë kur ajo është e pavarur dhe kur posedon trashëgiminë e saj”, pjesëmarrëse në trajnimin e feminizmit.

“Këto aktivitete të vogla ndikojnë në ndryshime të vogla personale, por që më pastaj e ka atë domino efektin e famshëm të bëhen ndryshime në familjet tona, komunitetet dhe shoqëritë që na rrethojnë, duke bërë kështu që nga viti në vit, edhe kohë pas kohe nuk jemi të vetëdijshme që raportet tona, Serbi-Kosovë, bëhen më të mira dhe më të natyrshme. Derisa koha kalon aq më shumë po kalojmë nga e keqja në drejtim të një të ardhme të përbashkët, të cilën e ndërtojmë në baza të tolerancës, mirëkuptimit dhe mundësive të përbashkëta. Kjo është ajo çka mua më jep shpresë dhe motiv, para së gjithash përmes AGC-së dhe Artpolis ta shtyjmë përpara këtë tregim, sepse ky është tregimi i së ardhmes”, Anita Pantelić nga organizata partnere “Qendra Alternative e Vajzave”.

“Kursi i vetëmbrojtjes Çikat e Sjellshme është një aktivitet shumë i qëlluar dhe i nevojshëm. Përgjatë këtyre orëve të mbajtura deri tani kemi mësuar teknika të ndryshme të vetëmbrojtjes dhe kemi formuar shoqëri që besoj se do të zgjasin gjithë jetën. Trajneri është jashtëzakonisht i përgatitur dhe i gatshëm t’i thjeshtësojë e t’i sqarojë teknikat për ne si fillestare. Mendoj se kursi ka pasur efekt pozitiv në rritjen e vetëbesimit dhe disiplinës për të gjitha vajzat dhe shpresoj se do të kemi mundësi të vazhdojmë edhe nivelet tjera”, Jona Kastrati.

ANEKSET

REPERTORI I SHFAQJEVE PROFESIONALE TË ARTPOLIS 2022

Premiera:
5

Shfaqje të prezantuara:
8

Repriza:
35

Artiste/ë:
70

Stafi teknik:
21

Audienca:
3488

Bashkëproduksione:
3

Vendet: Kosovë, Shqipëri, Sllloveni, Serbi, Maqedoni Veriore dhe Turqi

10 VJET FEMART – NGA REVOLUCIONI NË EVOLUCION

Aktivitete:
34

Artiste/ë dhe aktiviste/ë:
150

Vullnetare/ë:
10

Audienca:
2520

Audienca online:
348,432

Artikuj medial:
52

Bllogje të publikuara:
11

KLUBET TEATRORE DHE SHFAQJET FORUM TEATËR 2022

Klube Teatrore:
6

Shfaqje të prezantuara:
10

Pjesëmarrës:
104

Mentore/ë:
13

Staf teknik:
6

Audiencë:
730

AKTIVIZMI FEMINIST I ARTPOLIS 2022

Trajnime/Punëtori/Diskutime:
39

Trajnere/ë:
34

Pjesmarrës/e:
1053

Fondi për Art Feminist:
11 vepra artistike të përkrahura,
87 artiste/ë dhe 10 staf teknik të përfshirë

Marshe:
2

STATISTIKAT E MEDIAVE SOCIALE

ARTPOLIS // 1 Janar – 31 Dhjetor, 2022

	1,201,838 persona të arritur	2.075.576 reagime		
	198.170 persona të arritur			
	10,649 reagime	5,236 vizita në profil		
	5.132 përdorues	5.107 përdorues të rinj	6.603 sesione	14.630 vizita

Audienca: 11.091 pëlqime // Gra 67.7% // Burra 32.3%

Audienca: 2.235 ndjekës // Gra 70.2% // Burra 29.8%

FESTIVALI FEMART // 1 Janar – 31 Dhjetor 2022

	1.007.456 persona të arritur	2.075.576 reagime		
	31.591 persona të arritur			
	5.080 reagime	6.271 vizita në profil		
	3.376 përdorues	3.358 përdorues të rinj	4.477 sesione	7.239 vizita

Audienca: 10.226 pëlqime // Gra 75.4% // Burra 24.6%

Audienca: 2.771 ndjekës // Gra 73.2% // Burra 26.8%

DONATORËT E ARTPOLIS

Sponsor Gjeneral

Republika e Kosovës
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Sweden
Sverige

Funded by
the European Union



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

PRISHTINA

Republika e Kosovës
Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës

Zyra e Presidentës së Republikës së Kosovës

RRJETET SOCIALE TË ARTPOLIS DHE FESTIVALIT FEMART

ARTPOLIS

Artpolis - Art and Community / https://www.facebook.com/artpolisKosovo

ArtpolisCenter / https://www.instagram.com/artpoliscenter/

QendraArtpolis / https://twitter.com/qendraartpolis?lang=en

Artpolis - Art and Community / https://vimeo.com/artpoliscenter

https://artpolis-ks.com/

FEMART

FemArt Kosova / https://www.facebook.com/FemartKosova

FemArtKosovo / https://www.instagram.com/femartkosovo/

FemArtKosovo / https://twitter.com/FemArtKosovo

FemArt Festival / https://femart-ks.com/

FemArt Festival / https://bit.ly/3KoTtck

MONITORIMI I MEDIAVE

Gjatë vitit 2022 aktivitetet e Artpolis kanë pasur mbulueshmëri të gjerë nga mediat lokale dhe nacionale. Rreth **300 artikuj** janë publikuar nga media të ndryshme dhe më poshtë mund të lexoni disa prej tyre:

Premiera e “Çimka-s” në “shtëpinë e gjetheve”

https://bit.ly/3AZzTlX

Çimka – ose paralelet e përgjimeve totalitare

https://bit.ly/3MdeOqz

“Poezi për Fuqi” thërret barazinë, solidarizohet me Ukrainën

https://bit.ly/3OhVSHK

“Ora e vdekjes” në burg ngjall fatet njerëzore

https://bit.ly/3ao7nj6

“Pa zë” nxjerr gruan nga margjinat

https://bit.ly/3ynSq8B

“Qytetet Natën” - si perceptim i frikës së grave gjatë ecjes

https://bit.ly/3yol4q7

“Ndal luftën” në monolog me lirinë

https://bit.ly/3OPgmZB

Flamengo e homazhe në mbyllje të “FemArtit” për artin që shëron

https://bit.ly/3RhMs1z

“Qytetet Natën”, si perceptim i frikës së grave gjatë ecjes

https://bit.ly/3RhMs1z

‘FemArt’ nesër përmbyll edicionin me shfaqjen e baletit “Luxuria”

https://bit.ly/3RhMs1z

FemArt: Mbrëmja e sotme homazh për Vjosën, nderojmë angazhimin e saj artistik dhe

njerëzor

https://bit.ly/3nIBtRl

FemArt për Vjosën: Skena artistike humbi një nga gratë më të çmuara

https://bit.ly/3OJQy0V

“TOKA E SHPIRTRAVE TË TRAZUAR” HAP “FEMART”- in

https://bit.ly/3RjsSSy

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

TË ARDHURAT

TË ARDHURAT	€ 560,510
TOTALI I TË ARDHURAVE	**€ 560,510**

SHPENZIMET

SHPENZIMET E PAGAVE E STAFIT / PERSONATE JASHTËM	€ 273,863
SHPENZIMET OPERATIVE	€ 281,787
SHPENZIMET E ZHVLERËSIMIT	€ 4,860
TOTALI I SHPENZIMEVE	**€ 560,510**

TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET NGA DONATORËT

	TË ARDHURAT	SHPENZIMET
KTK	€ 41,744	€ 41,744
UNFPA	€ 22,887	€ 22,887
UNFPA 2	€ 13,560	€ 13,560
CDF	€ 55,667	€ 55,667
CFD	€ 68,491	€ 68,491
KCSF	€ 38,749	€ 38,749
MINISTRIA E KULTURËS	€ 117,000	€ 117,000
KOMUNA E PRISHTINËS	€ 10,000	€ 10,000
URGENT ACRION FUND FOR WOMEN'S	€ 32,530	€ 32,530
SDC	€ 25,309	€ 25,309
EU HLC	€ 38,189	€ 38,189
MINISTRIA E DIASPORËS	€ 5,000	€ 5,000
AMBASADA E LUKSEMBURGUT	€ 10,000	€ 10,000
SIGMA	€ 2,000	€ 2,000
BUÇAJ	€ 25,521	€ 25,521
GLOBAL ALBANIANS FOUNDATION	€ 42,513	€ 42,513
TË HYRA NGA ANËTARSIA	€ 230	€ 230
TË TJERA	€ 8,273	€ 8,273
TË HYRAT E SHTYRA NGA VITI PARAPRAK	€ 110,659	€ 2,847
TË HYRAT E SHTYRA TË VITIT AKTUAL	€ (107,812)	
TË ARDHURAT TOTALE NGA DONATRËT	**€ 560,510**	**€ 560,510**

Pasqyrat financiare janë përgatitur për qëllime raportimi në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar në fuqi dhe ato përfaqësojnë të gjithë pasqyrën që ka ndodhur në Artpolis gjatë vitit 2022. Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parave të gatshme, sipas së cilës të ardhurat dhe shpenzimet njihen në kohën kur merren ose paguhen. Organizata përdor Quick Books për të përgatitur pasqyrat financiare.

Më poshtë mund të gjeni linkun e Raportit të Auditimit të Artpolis për vitin 2022:

STAFI I QENDRËS PËR ART DHE KOMUNITET - ARTPOLIS, 2022

Zana Hoxha, Themeluese dhe Drejtore Ekzekutive

Donarta Limanaj, Menaxhere e Financave dhe Administratës

Diellza Bezera, Menaxhere e Projekteve

Nertila Qarri-Gërguri, Menaxhere e Projekteve

Venera Ismaili, Zyrtare e Projekteve

Elira Lluka, Zyrtare për PR

Berat Bajrami, Koordinator i Projekteve

Arbnora Kajtazi, Asistente e Financave

Valëza Sijarina, Asistente e Projekteve

Qendresa Hyseni, Asistente e Projekteve

Fiona Behrami, Asistente e Projekteve

Alba Ajdarevikj, Asistente e Projekteve

Ivana Bilić, Praktikante

TRUPA ARTISTIKE REZIDENTE E ARTPOLIS

Regjisore: Zana Hoxha

Koreograf: Robert Nuha

Dramaturg: Shpëtim Selmani

Aktoret/et: Blerta Gubetini, Donikë Ahmeti, Edlir Gashi, Kaltrinë Zeneli, Mikel Markaj, Qendresa Kajtazi, Zhaneta Xhemajli

Organizatore: Elira Lluka

BORDI I ARTPOLIS

Aurita Agushi | Jelena Memet | Kushtrim Qerimi | Dardan Kryeziu

artpolis art and community center